



STUDIMET POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEMA:

Reformat: Çelësi i zhvillimit të arsimit në Maqedoni

Reforms: The key to the Development of Education in
Macedonia

Реформите: Клучот за развој на образованието во
Македонија

KANDIDATJA:
Liridona Avdili

MENTORI:
Prof.Dr.Hasan Jashari

Tetovë, Maj 2018

Mirënjohje

Do të doja të falemnderoja familjen time për mbështetjen e tyre të pashtershme moralisht dhe financiarisht gjatë gjithë studimeve të mia deridiplomike dhe postdiplomike.

Pa mbështetjen e tyre unë nuk do të arrija në këtë fazë të fundit të studimeve.

Gjithashtu do të doja të falemnderoja mentorin tim profesor Hasan Jashari që më ka ndihmuar që tema e magistraturës të nxjerr përfundimin e paraparë.

Së fundi do të doja të falemnderoja të gjithë profesorët e UEJL që na udhëzuan drejt dijes.

Parathënie

Ky punim ka për qëllim të japë një përshkrim të qartë reformave të arsimit në Maqedoni.

Duke u bazuar në literaturën mbi reformat arsimore nga autor të huaj si dhe ata vendorë dhe duke analizuar ndryshimet që ndodhën në arsimin në Maqedoni, kam bërë përpjekje që të jap një përshkrim se si reformat ishin çelës të zhvillimit të arsimit në Maqedoni.

Reformat arsimore që ndodhën në vitet e fundit në Maqedoni, bënë ndryshime duke filluar nga struktura e shkollës, stafi pedagogjik, plan programi, etj. Nga praktika në Maqedoni, reformat dëshmuar se qysh në fillimet e para nuk arritën rezultatet e pritura, se për çdo reformë dhe ndryshim duhet kohë e caktuar deri në adaptim ose realizim, ndërsa disa të tjera edhe dështuan. Mirëpo çelsi i zbatimit të reformave parasheh parime të përgjithshme që të nxjerrin gjenerata të kualifikuara nga ndryshimet e qasjes të mësimdhënies dhe mësimnxënies me metoda dhe programe bashkohore. Duke parë nga afër reformat ne mund të jemi shumë më të saktë për mënyrën se si funksionojnë ndryshimet e brendshme në arsim.

Me anë të metodave dhe teknikave të ndryshme do të grumbullohen materiale faktografike dhe i njëjti do të seleksionohet, analizohet dhe do të interpretohet me një qasje kreative dhe kritike.

Fjalët kyçe: Arsim, Reformë, Cilësi

Abstract

This project provides a clear description of the education reforms in Macedonia. Based on the literature on educational reforms by both foreign and local authors and analyzing the changes that took place in Macedonia's education, efforts have been made to provide a description of how reforms that took place in recent years in Macedonia made changes starting from that school structure, the pedagogical staff plan program and so on.

From the practice in Macedonia the reforms prove that from the early beginnings they did not achieve the expected results because for each reform and change it would take time to adapt or to realize, while some failed. But the key to implementing reforms requires generic principles to bring qualified generation out of changes in access to teaching and learning by contemporary methods and programs. By looking closely at reforms, we can be more accurate about how internal changes work in education.

Through different methods and techniques, factum material will be collected and the same will be selected, analyzed and interpreted with a creative and critical approach.

Key Words: Education, Reform, Quality

Предговор

Овој проект има за цел да даде јасен опис на реформите во образованието во Македонија. Врз основа на литературата за образовни реформи од страна на странски и локални автори и анализирање на промените што се случија во образованието во Македонија се направени напори да се даде опис на тоа како реформите што се случи во последниве години во Македонија, направи промени кои започнаа од училишната структура, програмата за планови за педагошки кадар и сл. Од практиката во Македонија реформите покажуваат дека од раните почетоци тие не ги архивираат очекуваните резултати, бидејќи за секоја реформа и промена ќе биде потребно време да се прилагодат или да се реализираат, додека некои не успеале. Но, клучот за спроведувањето на реформите бара генерички принципи за да се донесе квалификувано генерација од промени во пристапот до учењето и учењето преку современи методи и програми. Со внимателно следење на реформите, ние можат да бидат поточни за тоа како внатрешните промени функционираат во образованието.

Преку различни методи и техники, фактоумскиот материјал ќе биде собрани и истите ќе бидат избрани, анализирани и интерпретирани со креативен и критички пристап.

Клучни зборови: Образование, Реформи, Квалитет

Lënda e Hulumtimit

Lënda e hulumtimit në këtë punim do të jetë “Reformat - çelësi i zhvillimit të arsimit në Maqedoni”.

Arsimi është fushë më e rëndësishme e shoqërisë dhe kombit. Nëpërmjet arsimit, shoqërisë u transmetohen dije, kulturë, vlera ku përmes tyre shkon një shoqëri përpara. Arsimi jo vetëm që i prinë shoqërisë, në të njejtën kohë ndikohet edhe nga ndryshimet që ndodhin në shoqëri. Një ndër çështjet më të rëndësishme në arsim janë edhe reformat. Reformat në arsim do të thotë të vihet në zbatim politika e fundit, përmes saj të ndryshosh, kulturën e klasave, shkollave, universiteteve. Me anë të reformave arsimit është munduar t’iu përshtatet sa më shumë ndryshimeve sociale në rrethinë, si edhe atyre globale.

Ndryshimet ekonomiko-shoqërore detyrimisht sjellin edhe në ndryshime në fushën e arsimit. Sistemet bashkëkohore të arsimit të mesëm tani për tani janë shumë më të ndryshëm dhe më të llojlojshëm në krahasim me sistemet e mëhershme duke mundësuar bazë më të llojlojshme dhe më të gjërë për qasje në arsimin e lartë (H; Jashari; v.2005 f.193).

Lëndë hulumtimi do të jëtë edhe çështja se cilat ishin reformat apo ndryshimet që ndodhën në arsim në Maqedoni? Deri në çfarë niveli u implementuan reformat? Çfarë ndryshime sollën reformat në shoqëri? Cilat ishin rezultatet dhe sukseset e reformave?

Qëllimi i hulumtimit

Reformat në arsim gjithmonë kanë qenë pjesë të procesit arsimor varësisht nga koha, rrethanat, vendet, reformat kanë arritur të sjellin risitë dhe ndryshimet me vete.

Qëllimi i këtij hulumtimi do të jetë:

Reformat- si çelësi i zhvillimit të arsimit në Maqedoni duke bartur të gjitha dinamikat dhe problemet e tyre të ndryshme në vetvete.

Gjithashtu si qëllim i punimit është të hulumtoj kur dhe pse ishin të nevojshme reformat të arsimit në Maqedoni. Cili është çelësi apo metoda për zbatimin më të suksesshëm të reformave apo ndryshimeve në arsim si segment i ndjeshëm i shoqërisë.

Hipotezat

Hipotezat kryesore të këtij punimi janë dy:

- Hipoteza gjenerale:

Reformat – çelësi i zhvillimit të suksesit në Maqedoni dhe nevoja që kishte arsimit për këto reforma.

- Hipoteza e veçantë:

Si hipotezë të veçantë kam zgjedhur rezultatet nga reformat në arsimin e fillor, të mesëm dhe të lartë në Maqedoni.

-Reformat dhe ndryshimet në zbatimin e tyre:

- Koncepti për arsimin fillor nëntëvjeçar;
- Testimi ekstern;
- Sistemi i Bolonjës.

Metodat e hulumtimit

Për t'u përgatitur ky punim janë përdorur këto metoda:

1. Metoda teorike;
2. Metoda komparative (krahasuese);
3. Metoda deskriptive; dhe
4. Metoda analitike .

Rëndësia e punimit

Arsimi është pjesa më e rëndësishme e jetës së njeriut, ku si individ dhe shoqëri mund të formohemi si moralisht ashtu edhe profesionalisht. Rëndësia e këtij punimi do të jetë ideja se sa kishin ndikim reformat në zhvillimin e arsimit në Maqedoni. Përderisa reformat në arsim janë ndryshim që kërkojnë më shumë vlerësim, nga rezultatet e tyre ka ndikime direkte në sukseset që arrijnë në shoqëri. Shkollat fillore, të mesme dhe fakultetet janë bazament për një shoqëri sa më të arsimuar në një shtet.

Përfundimi

Përderisa arsimi është shtylla e një shoqërie, arsyet e ngushta për reforma, tani, më janë të njohura thotë Fullan (2001 f.20), shoqëria globale po bëhet gjithnjë e më e ndërlikuar dhe kërkon qytetarë të arsimuar, që mund të mësojnë vazhdimisht, dhe që mund të punojnë në kushtet e shumëllojshmërisë, si në planin vendor dhe ndërkombëtarë dhe është pikërisht ky hulumtim, reformat në sistemin arsimor në Maqedoni sa e bënë përgatitjen e nxënësve, për t'iu përshtatur sa më lehtë ndryshimeve në shoqëri. Reforma e arsimit në Maqedoni jo çdo herë u zbatua ashtu siç duhej, por edhe kritika negative dhe dështime në disa segmente.

Lista e Grafikoneve

- 4.1.1
- 4.1.2
- 4.1.3
- 4.1.4
- 4.1.5
- 4.1.6
- 4.1.7
- 4.1.8
- 4.1.9
- 4.1.10
- 4.2.1
- 4.2.2
- 4.2.3
- 4.2.4
- 4.2.5
- 4.2.6
- 4.2.7
- 4.2.8
- 4.2.9
- 4.2.10

Lista e Shkurtesave

Koncepti për arsimin fillor nëntëvjeçar - KON

Programi Nacional Për Zhvillimin e Arsimit - PNZHA

Strategjia Gjithëpërfshirëse e Arsimit - SGJA

Testimi Ekstern, Notim Sfidë - TENS

Tabela e Përmbajtjes

Mirënjohje.....	I I
Parathënie.....	III
Abstract.....	IV
Предговор.....	V
Lënda e hulumtimit.....	VI
Qëllimi i hulumtimit.....	VII
Rëndësia e punimit.....	VIII
Përfundimi.....	VIII
Lista e figurave.....	X
Lista e shkurtesave.....	XI
Tabela e përmbajtjes.....	XII
Kapitulli I: Hyrje.....	1
1.1. Çka është arsimit.....	3
1.2. Edukimi për mirësjellje dhe arsimim.....	4
1.3. Llojet e arsimit.....	5
1.4. Sistemi arsimor në Maqedoni.....	7
1.5. Reformat e arsimit në Maqedoni.....	7
1.5.1 Reformat në arsimin fillor.....	9
1.5.1.1. Promovimi i arsimit fillor efektiv.....	XI 12

1.5.2. Arsimi i mesëm.....	14
1.5.2.1. Testim ekstern në arsimin e mesëm.....	15
1.5.3. Arsimi i lartë – Sistemi i Bolonjës.....	16
Kapitulli II: Literatura	19
2.1. Rishqyrtimi i literaturës – Pjesa teorike.....	19
Kapitulli III: Metodologjia.....	26
3.1. Qëllimi i hulumtimit.....	26
3.2. Metoda e përdorur në hulumtim.....	26
3.3. Hipotezat.....	27
Kapitulli IV: Analizimi i të dhënave.....	29
4.1. Rezultatet nga anketat në shkollat fillore.....	29
4.2. Rezultatet nga anketat në shkollën e mesme.....	37
Kapitulli V: Përfundimi.....	44
Bibliografia.....	50
Shtojcat.....	56

Kapitulli I: Hyrje

Duke parë zhvillimet në vitet e fundit të sistemeve arsimore dhe rëndësinë e ndryshimeve arsimore që ndodhin në shoqërinë tonë, si ndeshje të inovacioneve dhe ndryshimeve që ishin ngushtë të lidhura me zhvillimet e mjedisit që i rrethon, si në zhvillimet e ndryshimeve në aspektin nacional poashtu edhe në atë ndërkombëtar, reformimi i sistemeve arsimore ishte alternativë më e përafërt për të qenë më afër këtyre zhvillimeve. Përderisa arsimi është një proces, me anë të cilit bëhet zhvillimi i shoqërisë për një të nesërme më të mirë, ai duhej të ketë përshtatje të nivelit që kërkohet në botën globale. Shoqëria duhet të përgatitej në mënyrë edukative dhe arsimore për këto ndryshime. Proceset e sistemeve arsimore kanë qenë gjithmonë ai i edukimit dhe arsimimit. Të dy konceptet duhej të jenë të përcaktuar mirë, ai i edukimit që për synim kryesor ka zhvillimin e personalitetit, dhe ai i arsimimit si një proces i zhvillimit mentalitetit të shoqërisë në përgjithësi dhe individit në veçanti. Maqedonia në vitet e fundit ka bërë përpjeke që t'i mbështesë reformat arsimore, duke bërë ndryshime në organizimin, strukturimin, menaxhimin e sistemeve arsimore.

Ky punim do të fokusohet në rëndësinë e reformave arsimore, në kuptim të thellë për ndryshimet në arsim në dy drejtimet - njëri që lidhet me kuptimin e ndryshimit, dhe tjetri që ka të bëjë me rezultatet e ndryshimit. Në këtë punim do të kuptohet rëndësia e ndryshimeve, nga niveli shtetëror, dhe cilat ishin përfitimet në praktikë nga këto ndryshime apo këtyre reformave arsimore, cilat mësimet apo rezultate u nxjerrën nga këto ndryshime në praktikë.

Mësimet për këto reforma në sistemet arsimore do t'i analizojmë nga historiku i zhvillimit të procesit arsimor dhe reformave arsimore nga autorë të huaj si dhe vendorë, me njohuri më të thella për këtë drejtim, çfarë thanë ata në lidhje me domosdoshmërinë dhe rëndësinë e reformave arsimore për të arritur rezultate në praktikë. Ky hulumtim do të posedojë dy lloje të të dhënave: të dhënat sasiore dhe të dhënat cilësore. Të dhënat sasiore do t'i shpreh nga rezultatet e kërkuara në sasi gjatë anketave, dhe do të jenë të përpunuara me anë statistikore.

Dhe të dhënat cilësore prej të cilave synohet të paraqiten përvoja e mësimdhënësve gjatë reformave.

Në pjesën e parë të këtij punimi do të flasë për aspektin historik të lidhshmërisë së shoqërisë njerëzore me arsimin. Kuptimin mbi arsimin, konceptin e edukimit dhe arsimit, si dhe lidhshmërinë që e kanë këto dy koncepte në shoqëri, atë se çfarë kanë thënë autorë të ndryshëm për këto dy koncepte. Poashtu do të flasë edhe për zhvillimet e sistemeve arsimore në Maqedoni, dhe ndryshimet e fundit që kanë ndodhur në këto sisteme. Reformat arsimore në këto sisteme jo vetëm që nuk munguan, por ishin edhe të shumta.

Në pjesën e dytë do të bëj rishqyrtimin e literaturës atë se çfarë kanë thënë autorë të ndryshëm për reformat arsimore, përse janë paraqitur, si ka ecur zbatimi i tyre në praktikë, çfarë qëllime kanë pasur, çfarë metodologjie është përdorur gjatë praktikimit të tyre, për rezultatet më të mira nga ato reforma.

Në pjesën e tretë do të flas për metodologjinë e përdorur në këtë hulumtin, për të arritur në të dhëna sa më konkrete nga rezultatet e këtyre reformave. Përderisa prej metodave shkencore që përdorën në hulumtime shkencore në edukim janë: metoda e analizës së dokumentacionit, metodat përshkruese, metodat krahasuese (komparative), metodat historike, metoda statistikore, metoda e grupit të përqendruar (focus grupi) dhe metoda e vrojtimit. (Azemi B & Bujari R; 2013, f.21). Në këtë punim janë përdorur metodat e analizës së dokumentacioneve, metoda përshkruese, metoda krahasuese, dhe metoda statistikore.

Në pjesën e katërt do t'i paraqes të dhënat që janë marrë gjatë hulumtimit të këtij punimi.

Ndërsa në pjesën e pestë do të jetë i paraqitur përfundimi i punimit.

Në pjesën e gjashtë do të paraqes bibliografinë e shfrytëzuar në këtë punim.

1.1. Çfarë është Arsimi?

Nga historia e zhvillimit të njeriut, në kemi njohuri të mjaftueshme se në çdo shoqëri njerëzore ka pasur interes për arsim. Nga zhvillimet më të hershme që ka pasur shoqëria njerëzore, historia si shkencë humane që merrej me studimin e të kaluarës së njerëzimit, na tregon që ajo që ka qenë e lidhur ngushtë me zhvillimet e shoqërisë njerëzore, ka qenë edhe zhvillimi edukativo – arsimor. Profesori A. Mustafa thotë se "Edukata dhe arsimi duhet të kërkuar që në epokat e hershme të historisë, që në fazën e krijimit dhe diferencimit të jetës në klane, fise, në epoka ekonomike-shoqërore e deri te rënia e fisit, klanit apo rendit shoqëror"(Mustafa A; 1997, f.6). Çështja e arsimit dhe zhvillimit të shoqërisë njerëzore kuptuar që nga kohërat e lashta e deri më tani, që historitë për procesin e zhvillimit të njeriut, kanë qenë gjithmonë të kushtëzuara të jenë sipas kushteve historike- shoqërore.

Për termin arsim mund të themi se është i njëjti për shoqërinë, mirëpo si koncept ai nuk është më si ishte disa shekuj më parë. Përderisa me paraqitjen e njeriut dhe shoqërisë njerëzore, në zanafillën e vet që kishte edukimin si dukuri shoqërore, më vonë paraqitet edhe organizimi i arsimit në mënyrë më të përsosur për shoqërinë njerëzore. Edhe për këtë historia ka arritur të na japë një pasqyrë të qartë, për ndryshimet që ndodhën në aspektin e edukimit, dhe arsimit në shoqërinë njerëzore, i cili ka kaluar nëpër shumë faza. Nga ndryshimet që kanë ndodhur në shoqëri, ato kanë arritur gradualisht të kenë zhvillime në arsim, kulturë dhe civilizim. Arsimi ka qenë gjithmonë, proces që ka pasur përmirësime të vazhdueshme, në varësi të kohës, vendit, dhe rethanave. Për këtë histori të zhvillimit të shoqërisë njerëzore me aspektin e arsimit, profesor Hasan Jashari thotë se "Historia e zhvillimit të shoqërisë njerëzore na tregon se i tërë zhvillimi i qytetërimit dhe i ideve në përgjithësi ka qenë i ngadalshëm dhe me ndërlidhje të përhershme reciproke. Po nga ai kuptojmë se kjo rritje ka qenë çdoherë delikate, dhe bashkëvepruese me ngjarjet historike, dhe se ky proces ka qenë botëror, global, që para 2500 viteve. (Jashari H; 2005, f.198).

Krahas zhvillimeve të shoqërisë njerëzore, u paraqiten edhe sistemet arsimore. Paraqitja e sistemeve arsimore si qëllim në vete kishte organizimin e proceseve arsimore në shoqëri. Përdërisa shoqëria njerëzore kishte nevojë për dije, njohuri, shkathtësi dhe qëndrime për të udhëhequr një jetë sa më produktive, këtë mund ta arrinin më lehtë nëpërmes organizimit dhe sistematizimit të arsimit. Kuptimi i arsimit mund të përpilohet edhe nga shpjegimi i arsimit të cilit Mark K.Smit thotë se “Arsimi, siç e kuptojmë këtu, është një proces i ftesës për të vërtetën dhe mundësinë, për të inkurajuar dhe për të dhënë kohë për zbulimin. Është, siç tha John Dewey (1916), një proces social - "një proces jetese dhe jo një përgatitje për jetesë të ardhshme"(Smith M; 2015). Nga kjo mund të themi se arsimi është sistem i cili qëllim kryesor të tij e ka nxjerrjen dhe zhvillimin e potencialit të individit dhe shoqërisë.

1.2. Edukimi për mirësjellje dhe arsimim

Lidhshmërinë që kanë këta dy koncepte, që nga zanafilla e vetë, është karakteristikë themelore që kanë formimin e individit dhe të shoqërisë, apo formimin e individit për t’iu përgjigjur kërkesave të shoqërisë. Etimologjikisht fjala “edukim” rrjedh nga fjala latine “educare” që do të thotë, rritë, kultivoj, riprodhoj (Ndrecaj M; 2000.f.). Duke u nisur nga ky shpjegim që i bëhet fjalës edukim në fjalor, kuptojmë atë që edukimi bën në një kuptim formimin global të individit, në aspekte dhe nivele të ndryshme, si morale, sociale, religjioze, mjekësore etj.

Nga kjo që potenciam më parë gjithashtu mund të themi se edukimi është proces i cili për qëllim ka formimin e përgjithshëm dhe të veçantë të individit. Prosesi i edukimit të njeriut paraqet nxënie të njohurive, shkathtësive dhe aftësive për zotërimin me mënyrat për përmbushjen e nevojave (komponenta arsimore) dhe fitimin e përvojave jetësore dhe të punës, formimin e qëndrimeve, zhvillimin kritik ndaj punës, të mirës, vlerave botërore rreth tij (komponenta edukative). (PNZHA 2005-2015)

Si proces apo veprimtari që është edukimi, ai mund të jetë formal dhe jo formal, individual apo shoqëror, privat apo publik, gjithmonë në dispozicion për të kultivuar aftësi, vlera, dhe qëndrime në shoqëri. Anë tjetër e edukimit është se individët, pajisen me njohuri të nevojshme, për të marrë pjesë në jetën e komunitetit si qytetar. Profesor H. Jashari në librin e tij ‘Sociologjia e Arsimit’ citon Hegelin për njeriun dhe arsimin si “ Njeriu për nga natyra e vet nuk është ai që duhet të jetë prandaj i duhet arsimimi; ngritja mbi atë që është individuale në atë që është universale”. (Jashari H; 2005, f.20).

Nga aspekti filozofik i edukimit nënkuptojmë, se edukimi jep edukator që kanë vizion, të cilët bëjnë udhëzime të individëve dhe shoqërisë, për një arsim sa më cilësorë. Sa ka ngjajshmëri edukimi dhe arsimit i njeriut, edhe këtë aspekt e shpjegon H. Jashari, për të cilën thotë: “Nëse bëhet dallim ndërmjet asaj që është arsimuese dhe asaj që është edukative ose shoqërorizuese, do të mund të përfundojmë se në vend të parë është arsimit, në vend të dytë gati në mënyrë të njëjtë janë së bashku edhe arsimit, edukimi dhe socializimi dhe në vend të tretë poashtu shikuar në përgjithësi nuk ekziston ndarje e rreptë dhe tërësore ndërmjet asaj që është edukative dhe asaj arsimuese”. (Jashari H; 2005, f. 6). Pra nga lidhshmëria dhe rëndësia që kanë këto terme kuptojmë se edukimi dhe arsimit janë dukuri të cilat thuajse gjithmonë kanë qëndruar pranë njëra tjetrës në zhvillimin e individëve dhe shoqërisë. Për këtë arsimit është një pjesë integrale e edukimit dhe veprimtarive pedagogjike, që lidhet drejtëpërdrejtë me edukimin.

1.3. Llojet e Arsimit

Për arsimin si koncept që përmendëm më lartë, ngaqë sot nuk është më ai arsim si në kohët e lashta, mund të kuptojmë, çdo përvojë apo veprimtari që ka një efekt formativ, në mendje, karakter apo aftësi të një individi. Duke parë nga kuptimi teknik, arsimit shihet si një proces me anë të të cilit shoqërisë i transmetohen njohuri, dije dhe vlera nga një brez në brezin tjetër.

Bazament arsimit në shoqëri ka të mësuarin sistematik, nga i cili jo vetëm që duhet shoqëria njerëzore të marrë njohuri, por edhe të aftësohen në zotërimin e tyre në mënyrë sa më të përpiktë, individët të furnizohen me shkathtësi dhe vlera shoqërore.

Konceptet për arsim permanent aplikohen në mënyra të caktuara, dhe sipas kriterëve që ndahen ato janë:

- arsimi formal (shkollat, institucionet);
- arsim joformal (jo shkencore, jo institucionale).

Arsimi formal - është arsim që kryhet në mënyrë të qëllimshme, nga nxënësit apo studentët, dhe përfundon me certifikime, apo me diploma. Ky lloj i arsimit organizohet në mjedise të organizuara si shkolla, fakultetet, institucione, i cili strukturohet dhe dizajnohet me kurrikula të qarta mbi të nxënësit dhe në lëmi, si dhe aspekte të caktuara. Shpjegim që i jepet këtij lloji të arsimit, në Strategjinë e Arsimit është se mësimi formal është çdo herë i organizuar dhe strukturuar, dhe ka qëllime mësimore. Nga këndvështrimi i pjesëmarrësit/nxënësit, çdoherë synohet, gjegjësisht qëllimi eksplicit i pjesëmarrësit/nxënësit është të përfitojë njohuri, shkathtësi dhe kompetenca.

Për dallim nga arsimi formal, arsimi jo formal strukturohet në mënyrë shumë më specifike, dhe krijohet për të përmbushur nevojat e caktuara të njerëzve, dhe sipas kohëzgjatjes, është arsim afatshkurtër. Arsimi jo formal në rastet më të shpeshta organizohet për të rriturit, i cili përcakton proceset e organizuara të mësimin të orientuar në drejtim të aftësimin të të rriturve për punë, për aktivitete të ndryshme sociale apo për zhvillim personal. (Ligji për Arsimin e të rriturve). Arsimi joformal nuk është përpiluar në mënyrë pedagogjike si duhet: plani, programi, teknologjia arsimore, verifikimi etj, por gjatë realizimit u lihet liri realizatorëve që vetë ta formojnë procesin arsimor. (Plan Programi Shkollor)

1.4. Sistemet Arsimore në Maqedoni

Përderisa me termin sistem arsimor kuptojmë tërësi të metodave që janë të përpiluara ose të hartuara me ligj nga shteti ose qeveritë, të cilët për qëllim kanë organizimin e procesit edukativo arsimor të nxënësve, studentëve në shkollat publike, private, universitete, edhe në Maqedoni bëjnë organizim të tillë të sistemeve arsimore. Sistemet arsimore që përfshihen në Republikën e Maqedonisë kanë këto nivele të arsimit:

- arsimin fillor;
- arsimin e mesëm; dhe
- arsimin e lartë, universitar.

Ndryshimet në sistemet arsimore në Maqedoni, në dekadat e fundit ishin gjithnjë e më prezente. Nisur nga arsimi fillor, arsimi i mesëm si dhe ai i lartë, inovacionet dhe refomat ishin gjithnjë e më të shpeshta. Çështje kryesore e këtyre reformave në Maqedoni, ishte se ata shiheshin si mekanizma, për përshtajten e sistemeve arsimore me vendet më të zhvilluara. Për reforma në sistemet arsimore, ishin edhe ata se nga njëra anë u paraqitën ndryshime në humanizëm dhe shoqëri, nga ana tjetër zhvillimet tekniko –teknologjike, shkollat shiheshin si subjekte për t’iu përshtatur në mënyrë sa më adekuate këtyre ndryshimeve. Me anë të përshtajtes së kërkesave të reja, sistemet arsimore do të ishin si segmente kryesore për përparime në zhvillimet shoqërore dhe ekonomike, ku do të kenë kompetenca në mënyrë sa më adekuate t’i përgjigjen kërkesave në shoqërinë globale, dhe tregut të punës.

1.5. Refomat Arsimore në Maqedoni

Nga veprimtaria shoqërore është e njohur se fjala reformë është shndërim, apo ndryshim që bëhet në një fushë të caktuar. Për ndryshimet apo reformat që ndodhin në kohën tonë Fullan

thotë se “Në jetën e shoqërive vjen një kohë kur mund të ndodhin zbulime rrënjësore ose shkatërrime. Forcat e ndryshimit arrijnë në një pikë shpërthimi. Ndërsa po shkojmë drejt shekullit 21, ne jemi në një periudhë të tillë” (Fullan M; 2001 fq.8). Një kohë ku dinamika e ndryshimit në shoqëri është gjithnjë e më shumë në lëvizje, kërkesa për njerëz të arsimuar janë gjithnjë e më të mëdha, ndryshimi është i pashmangshëm për shoqërinë, arsimi si fushë më e rëndësishme e shoqërisë njerëzore, duhet të jetë gjithnjë e më afër këtyre ndryshimeve”. S’do mend se qëllimi moral i reformës arsimore, duhet të përfshijë ndërtimin e kapaciteteve si rrugë për zhvillim individual dhe shoqëror. (Fullan M; 2001 f.230). Shikuar nga këndvështrimi social, ndryshimi në kuptimin sistematik, nuk është edhe çështje e thjeshtë, njerëzve i’u duhen shembuj apo modele për të punuar. Maqedonia për përshtatje të sistemeve arsimore me vendet më të zhvilluara, për ndryshime të propozuara janë marrë vendet si Austria, Britania e Madhe, Gjermani, Franca, Suedia, Sllovenia, Kroacia. Këto propozime janë marrë për zhvillimet dhe arritjet bashkëkohore në shkencë, arsim dhe edukim. Rekomandimet kanë qenë nga Këshilli Evropian dhe Organizatat tjera ndërkombëtare.(KON) Veçanti për propozimet e rekomanduara kanë qenë:

1. rritje të kohëzgjatjes të arsimit fillor të obligueshëm dhe
2. promovim të arsimit fillor efektiv.

Duke u nisur nga ajo, që cilësia është kërkesa themelore e çdo veprimtarie në botën e zhvilluar, në sistemin për arsim të mesëm në Maqedoni, krahas reformave arsimore, filloi të zbatohet edhe Testimi Ekstern i nxënësve. Në fakt, ky lloj testimi nuk u aplikua vetëm në sistemin arsimor të mesëm ai u aplikua edhe në atë të arsimit fillor. Kjo metodë e re për matjen e cilësisë së arsimit në sistemin për arsim fillor dhe atë të mesëm, shihej se i paraprinte anëve më të dobëta të praktikave arsimore të kaluara, ku kishte mungesë kontrolli në cilësinë e arsimit. Kjo formë e kontrollit kërkonte standarde të përkufizuara, në mënyrë të qartë për arritjet e nxënësve të cilat duheshin të ishin, dhe ato të ishin transparentë dhe të

arritshme.

Reformë arsimore në arsimin e lartë konsiderohej prej se filloi aplikimi i Sistemit të Bolonjës. Procesi i Bolonjës si iniciativë e përbashkët e vendeve të Evropës në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare nga fusha e arsimit, universiteteve, organizatave të studentëve dhe partnerëve social, deklarata e cila u nënshkrua në vitin 1999, bëri që Maqedonia t'i bashkangjitet këtij sistemi në vitin 2005, për zhvillime moderne sociale dhe ekonomike, në institucionet e arsimit të lartë.

1.5.1. Reformat në Arsimin Fillor

Koncepti për arsimin fillor nëntëvjeçarë

Krahas ndryshimeve që kishin filluar të ndodhin në kohë të fundit në sistemet e arsimit fillor në botë, edhe Maqedonia filloi të bëjë përpjekje thelbësore për një arsim fillor sa më cilësorë, me qëllim që arsimit të korrespondojë me arsimin fillor e vendeve më të zhvilluara.

Maqedonia si shtet, prej kur fitoi pavarësinë e vet në vitin 1991, ligjin e parë për arsim fillor si shtet i pavarur e sjell në vitin 1995, ndërsa koncepti për përmbajtjen dhe organizimin e arsimit fillor tetëvjeçarë është sjellur në vitin 1996, dhe të njejtin vit ka filluar gradualisht zbatimi i tij . Me anë të atij ligji arsimit fillor u organizua sipas modelit të shkollimit bazik, i cili ishte i sistemuar sipas skemës 4+4 i cili përputhej me mësimin klasor dhe lëndor (Jashari H; 2005. f.101). Mësimi me këtë sistem ka vazhduar, deri në vitin 2007 akademik, sipas të cilit shkollat tetëvjeçare ishin të ndara në mësim klasor , i cili u zhvillua prej klasës së parë deri të katërtën , dhe mësimi lëndor prej klasës së pestë deri në klasën e tetë. Në ligjin për arsim fillor janë bërë përmirësime dhe ndryshime deri në vitin 2008 (USAID Macedonia). Në ligjin për arsim fillor të aprovuar në vitin 2008 sistemi i arsimit fillor ndryshon, ku hyn në fuqi ligji për arsim fillor nëntëvjeçarë.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja për Zhvillim të Arsimit në vitin 2007

përpilojnë konceptin për arsim fillor nëntëvjeçar, qëllim i analizës në këtë dokument ishte, që të japë raport për arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë si dhe vendeve më të zhvilluara të Unionit Evropian. (KON). Ky koncept u përpilua nga komisioni në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Në vendimet e propozuara në koncept nga anëtarët e komisionit, vendimet përfundimtare u morën nga opinioni i profesionalizuar pas debatit publik për propozim dokumentin. Po në këtë dokument ishin të përfshira edhe aspektet kyçe për formimin e konceptit për arsim fillor nëntëvjeçar, dhe planin mësimor në shkollat fillore.

Aspektet e qëllimit ishin:

- Organizimi dhe udhëheqja në arsimin fillor;
- Struktura e planit mësimor;
- Planifikimi i mësimi;
- Arsimitimi i fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore;
- Vlerësimi i nxënësve dhe përparimi në arsim;
- Arsimitimi i arsimtarëve dhe kompetencat e tyre;
- Bashkëpunimi me prindërit; dhe
- Tekstet shkollore dhe doracakët. (KON)

Ideja për reformin, në aspektin e organizimit dhe udhëheqjes në arsimin fillor, synim në vete kishte edhe rritjet e kohëzgjatjes së arsimit fillor të obligueshëm. Kjo ishte një masë preventive për eliminimin e pengesave që nxisnin braktisjen e mësimi nga nxënësit. Me sistemin e ri për arsim fillor nëntëvjeçar të obligueshëm, regjistrimi i nxënësve në shkollën fillore bëhet nga mosha 6 vjeçare dhe zgjat deri në moshën 15 vjeçare. Një nga arsytet e

organizimit të këtillë të arsimit fillor të obligueshëm nga mosha 6 vjeçare ishte ajo, se në sistemin e vjetër, që regjistroheshin fëmijët në klasë të parë të gjithë nuk kishin të ndjekur vitin përgatitor apo parashkollor, arsye për këtë kanë qenë nga më të ndryshmet, si mungesa e institucioneve publike dhe private në vendet rurale, familjet me arsim më të ulët dhe nga mjediset më të varfëra, poashtu edhe kjo ishte njëra nga masat preventive, të jenë të gjithë fëmijët të përfshirë në edukim parashkollor. Me organizimin e arsimit fillor të obligueshëm nga mosha 6 vjeçare, parashihej përputhshmëri, në nivelin e fëmijëve me aftësi apo dije të njejta në klasë të parë.

Struktura për organizimin e arsimit fillor nëntëvjeçar, që u propozua në reformat e arsimit fillor, ishte se arsimi fillor do të organizohet në tre periudha, 3+3+3, (periudha e parë prej klasës së 1-3, periudha e dytë prej klasës 3-6, dhe periudha e tretë prej klasës së 6-9) të cilat përkufizonin nivelet formale të shkollimit. Ky organizim i strukturës filloi në gjeneratat e para të arsimit fillor nëntëvjeçar, në vitin 2008. Karakteristikë për organizim të këtillë të strukturës së shkollimit, ishte lidhshmëria e periudhave edukativo-arsimore, të kenë përputhje me zhvillimet kognitive dhe social-emocionale të fëmijëve.

Maqedonia në planin zhvillimor 2008-2013, në suaza të “arsimim më të mirë për të gjithë” e implementoi edhe zhvillimin e hershëm të fëmijëve të moshës parashkollore (UNICEF - 2009). Qëllim për unifikim të sistemit arsimor nëntëvjeçar, si qëllim kishte: arsim fillor dhe të obligueshëm për të gjithë fëmijët, edukimi dhe arsimi fillor të jetë i orientuar kah zhvillimi i personalitetit të fëmijës dhe vlerave themelore të njeriut, shkolla fillore t’i mbështes fëmijët që të zbulojnë veçantitë e tyre si individ dhe në mënyrë më aktive për një jetë me përgjegjësi demokratike në shoqëri.

Për t’u realizuar një ndryshim i këtillë në strukturën e organizimit të arsimit fillor nëntëvjeçar, problem paraqitet kuadri mësimor. Me fëmijët në sistemin e vjetër kanë punuar, edukator me arsim të lartë, ose studime të kryera në institucione pedagogjike. Për këtë rast

Maqedonia paraqet obligim ligjor që edukatorët e grupit përgatitor të kenë të kryer studime për mësimin klasor, (mospërputhje në raport) me arsim inicial të edukatorëve dhe arsimtarëve të cilët punojnë me fëmijët e moshës gjashtëvjeçare (KON). Për t'iu përgjigjur kësaj kërkesë në reformat arsimore, Maqedonia filloi të zhvilloj mekanizma për avancimin e arsimtarëve, (bashkëpunorëve) jo vetëm për mënyrën se si do të realizohen programet që ishin për ndryshim, por edhe për të rritur cilësinë e të arriturave të nxënësve. Pra, ajo që duhej të arrihej ishte rritja e cilësisë në sistemin arsimor në përgjithësi.

1.5.1.1. Promovimi i Arsimit fillor Efektiv

Në sistemet për arsim fillor dhe të mesëm synim ishte rritja e cilësisë së arsimit. Ndërtimi i shkollave efektive, ku do të promovohet arsimi efektiv, kishte qëllim vendosjen e punës nën një kriter-cilësinë. Përderisa nga sistemi i vjetër, programet arsimore ishin të drejtuara kah aspekti përmbajtësor, qasja e re duhej të bazohej në rezultate. Për të arritur deri te kjo pikë, shkollave i duhej unifikimi (ndërtimi) i indikatorëve të suksesit, po ashtu edhe atyre të efikasitetit në përgjithësi. Indikatorët (treguesit) për shkolla efektive përfshinin këto fusha: Infrastrukturë shkollore, mësimi, mësimdhënia, udhëheqja dhe bashkëpunimi me bashkësitë lokale (PNZHA; 2005-2015).

Shkollat efektive po ashtu duhej të promovonte mësim për të gjithë fëmijët në bashkësi, të nxit pjesëmarrjen e fëmijëve për të mësuarit aktiv, të promovon përvetësim dhe zhvillim të shkathësive njerëzore (PNZHA;2005-2015)

Mësimdhënësit, gjatë mësimin, duhet të jenë të orientuar në metodologji sa më bashkëkohore që të zhvillojnë mësimin. Të kenë proces të definimit efektiv të kurrikulave, në mënyrë që të realizojnë mësimin, mundësim të kalimit kurrikular dhe instruktiv të metodave të ligjërimit. Konkretisht të praktikohet sa më shumë të mësuarit e përmbajtjeve dhe shkathësive nga ana

e nxënësve. Nga kjo metodë e ligjërimit, nxënësve do t'i mundësohej të jenë më të përfshirë në aktivitetet mësimore, ku do të kenë më të lehtë nxënien e diturive, shkathtësive dhe një sëndërtim më të lehtë të njohurive. Këtu duhej të bëhej modernizimi i procesit mësimor dhe mësimin në arsimin fillor.

Nëpër shkolla duhej të largoheshin metodat apo mësimi tradicional në procesin arsimor, nga mësimdhënësit kërkoheshin të praktikonin mësimin interaktiv dhe aktiv për nxënësit, mësimdhënësit duhej ta ndryshonin atmosferën në klasë ku interaksioni i nxënësve të ketë rol udhëheqës. Nxënësit duhen të jenë të nxitur për mësim të mëvetëdijshëm dhe kritik, për punë individuale dhe në grupe, për punë projektuese si dhe hulumtime të pavarura, poashtu nëpër orët mësimore mësimdhënësit duhet të përdorin TIK Teknologjinë si dhe sisteme të ngjajshme, si projektor. Për lëndët si gjeografia, biologjia dhe kimia shkollat duhet të kenë kabinete, që në mënyrë sa më të qartë ta kenë atë që e mësojnë në teori dhe të jetë më e kuptueshme dhe më e lehtë për nxënësit.

Paralel me këto ndryshime në arsimin fillor, ishte edhe aspekti i notimit të nxënësve, ku prej klasës 1-3 nxënësit fillojnë të notohen me notim përshkrues, ku secili nxënës duhet të notohet në bazë të përcjelljes me forma dhe procedura të ndryshme për kontrollin e njohurive.(KON)

Ndërsa nga klasa e 4-6 mësimdhënësit do të duhej të kombinonin notimin, me shkrim dhe me numra. Kurse nga klasa e 6 - 9 nxënësit marrin marrin dëftesa me nota numerike për secilën lëndë. Kur jemi tek notimi i nxënësve në shkollat fillore në Maqedoni u aplikuan dy lloje notimesh tek nxënësit. Përveç notimit intern që i bëhej nxënësve nga arsimtarët, në shkolla u aplikua edhe Testimi Ekstern ose Vlerësimi i jashtëm. Në shkollat fillore testimi i nxënësve bëhej në dy lëndë. Këto dy lloje të notimit u aplikuan deri në vitin 2017, derisa nga shkollat u tërhoq Testimi Ekstern ose Vlerësimi i Jashtëm i nxënësve.

1.5.2 Arsimi i mesëm

Zhvillimet shoqërore - ekonomike që ndodhin në botë ishin njëri nga shkaqet që paraqiten për reforma në arsimin e mesëm. Poashtu faktor kryesor mund të përmendim se kishte dallime në sistemin në atë se çfarë arsimi i nevojitej nxënësve dhe asaj që merrnin nxënësit nga arsimi i mesëm. Rëndësia e kësaj reforme duhej të korrespondonte me atë, që sistemi i mesëm arsimor të realizonte funksionin e vet shoqëror, në përgatitjen e qytetarëve për një veprimtari shoqërore dhe me kompetenca bashkëkohore. Shkollat e mesme në Maqedoni, duhej të plotësonin kërkesat e ekonomisë, lidhshmërinë në mes të arsimit dhe tregut të punës, duhej të kishin përsosje të planeve dhe programeve arsimore, plotësim të barazpeshës mes arsimit të përgjithshëm dhe profesional, të krijoj kushte për përsosje profesionale të vazhdueshme të mësimdhënësve. Me një ndryshim në këto aspekte, do të dëshmonte ndikimi i funksionit të arsimit në shoqëri. Misioni global i arsimit të mesëm dhe pas të mesëm, për të cilin angazhohet ky Program, nënkupton vendosje të një sistemi të hapur dhe efikas i cili do sigurojë qasje të barabartë për të gjithë shfrytëzuesit dhe zhvillim individual të personit nëpërmjet përfitimit të kompetencave të domosdoshme për punë të suksesshme, arsimim të mëtutjeshëm dhe jetë në shoqëri demokratike, në pajtim me mundësitë shoqërore-ekonomike lokale dhe globale, interes dhe nevoja.(PNZHA2005-2015)

Aktivitetet kryesore drejt të cilave duhej të lëviznin ndryshimet në sistemin për arsim të mesëm ishin; vendosja e formës së punës modulare e për të mundësuar fleksibilitet të nënsistemit, për adaptim të ndryshimeve në jetën shoqërore. Në organizimin e procesit arsimor, ndryshime në kurrikulum, si dhe zvogëlim të nxënësve nëpër paralele.

Të bëhen kombinime në shndërrimin e diturive, mes pjesës teorike dhe asaj praktike në dituri, të inovohen paisjet dhe materialet arsimore, si dhe të bëhet ngritje profesionale të kuadrit arsimor në lëndët profesionale-teorike dhe trajnime praktike.

1.5.2.1. Testimi Ekstern në arsimin e mesëm

Risi tjetër në sistemin për arsim të mesëm ishte edhe ajo për matjen e cilësisë së arsimit në shkollat e mesme, për arritjet në procesin arsimor, që llogaritej të ishte një tregues relevant i cilësisë së arsimit në shkollat e mesme. Përveç notimit të brendshëm që u bëhej nxënësve nga ana e mësimdhënësve, Ministira e Arsimit dhe Shkences (MASH), paraqet një mekanizëm për vlerësimin e cilësisë në shkollat e mesme, Testimin Ekstern ose Vlerësimin e Jashtëm. Testimi Ekstern u paraqit si pjesë e integruar e Programit për siguri dhe kontroll të kualitetit në arsim i cili është i konceptuar në mënyrë që të siguroj dhe të garantoj cilësi në arsimin fillor dhe të mesëm, dhe është në përputhje me sistemet e vendeve më të zhvilluara.(PNZHA 2005-2015).

Nevoja për të aplikuar Testimin Ekstern në arsimin fillor dhe të mesëm është vërtetuar dhe dokumentuar në Programin Nacional për Zhvillimin e Arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015, ku, ndër të tjera, si arsye përmenden subjektivizmi në vlerësimin e mësuesve, si dhe tendenca e rritjes (gjithnjë e më e theksuar) në përqindjen e nxënësve të shkëlqyer në vitet e fundit. Si një arsye shtesë thekson rezultatin e dobët të nxënësve maqedonas nga testimi i PISA (Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve) të vitit 2000, Maqedonia u rendit në mesin e më të dobtëve nga fushat e shkencave natyrore, matematikë dhe kapacitetin për të kuptuarit e leximit. (TENS 2016)

Qëllimi i këtij testimi ishte të përcaktojë objektivitetin në vlerësim apo notat e mësimdhënësve, si dhe matjen e nivelit të të arriturave të njohurive tek nxënësit. Kjo metodë e standardizuar e vlerësimit të jashtëm, u paraqit për të parë arritjen në cilësinë e arsimit, krahas reformave të tjera në arsimin e mesëm. Në koncept, Testimi Ekstern ose Vlerësimi i Jashtëm ishte përcaktuar kryesisht nga dy tipare:

I pari –tregonte aspektin e notimit ekstern gjegjësisht ekzistenca e institucionit të jashtëm dhe të pavarur që kontrollon, monitorimi dhe analiza e rezultateve të notimit në mënyrë që të

siguroj përgjegjshmëri dhe përmirësimin e cilësisë; dhe

I dyti –ka të bëjë me notimin aktual (testimin) të njohurive të arritura dhe aftësive të nxënësve. (PNZHA ;2005-2015)

Kjo metodë e testimit të nxënësve, e injoronte thujse tërësisht aspektin formal të notimit nga ana e mësimdhënësve. Ishte kjo ana e dobët që u paraqit në Testimin Ekstern, sepse nga kjo metodologji e vlerësimit, nuk janë marrë në konsideratë vlerësimet sumative dhe formative që janë kryer gjatë vitit shkollor nga ana e mësimdhënësve. Karakteri teknik dhe formal i këtij lloji të vlerësimit në vete ka mbartur edhe ngatërresa në notën përfundimtare të nxënësve.(TESN; 2016)

Testimi Ekstern i nxënësve bëhej në dy lëndë, të cilat lëndë ishin të përcaktuara nga MASH për të konstatuar nëse nota e testimit ekstern do të barazohej me notën e shënuar nga mësimdhënësit, me qëllim që të maten njohuritë dhe shkathhtësitë që i kanë arritur nxënësit gjatë vitit shkollor. Testet ishin të përpiluara nga Qendra Shtetërore për Provime, me propozim të Byros për Zhvillim të Arsimit. (KON).

1.5.3. Arsimi i lartë - Sistemi i Bolonjës

Kur jemi te ndryshimet në sistemet arsimore në Maqedoni, vend të veçantë për rëndësinë e ndryshimeve, paraqitet edhe me arsimin e lartë. Sikurse sistemet për arsim fillor dhe të mesëm, edhe sistemi për arsim të lartë duhej të arrinte kushte apo kritere për t'iu bashkangjitur vendeve më të zhvilluara me arsim. Edhe arsimi i lartë duhej t'i plotësonte standardet, të cilat në marrëveshjet ndërkombëtare, ishin të inicuar dhe të mbështetura për reforma. Në arsim të lartë kërkohej që të ketë kushte kualitative dhe kuantitative për çështjen jetësore të arsimit, kushtet e punës, arsimimi, të notuarit e mësimdhënësve, kurrikulumet, librat dhe tekstet e ndryshme, pajisjet teknike, etj.(Jashari.H ; 2005 f.190).

Politikat arsimore më të avancuara që ishin në sistemin e Bolonjës, bënë që të nxisin ndryshime në metodat e mësimdhënies dhe të nxënit, kështu duke i bërë universitetet më kompetitive dhe efektive, po ashtu duke nxitur që të zhvillohet lëvizshmëria akademike për mësimdhënësit dhe studentët, duke promovuar mësim, ku në qendër është studenti, me një ndërtim të mirëpërcaktuar të cikleve të arsimit të lartë, si dhe duke krijuar një shtesë të diplomat dhe duke mbështetur një degë përmes ECTS – European Credit Transfer System (Drita E ; 2016).

Maqedonia u bë anëtare e Procesit të Bolonjës në vitin 2003, edhe pse me ndryshime kishte filluar nga viti 1999, por për shkak të shfaqjeve të dobësive të paraqitura në implementim të ndryshimeve, merren masa që deri në vitin 2010, të gjitha universitetet të transformohen në universitete të integruara, që të kompletohet i gjithë procesi. (PNZHA ; 2005-2015).

Ndryshimet në organizimin e cikleve të arsimit të lartë në Maqedoni, nga fillimi i organizimit të arsimit sipas sistemit të Bolonjës, ishin vitet e studimit, ku cikli i parë ose studimet deridiplomike zgjasnin tre deri në katër vjet në varësi prej programeve të studimeve, cikli i dytë ose postdiplomike 1,5 ose 2 në varësi prej profileve (PNZHA;2005-2015), si dhe i treti ose të doktoraturës 3 vite. Organizimi i këtillë mundësonte lidhshmëri më të përafërt në mes shkallëve të studimit. Shkallët në ciklin e parë të studimeve mundësojnë hyrje, në programet e ciklit të dytë, si dhe shkallët e ciklit të dytë mundësonin hyrje në shkallën e tretë, tek ato të studimeve të doktoraturës.

Mobiliteti apo lëvizshmëria e mësimdhënësve dhe studentëve, e cila u realizua me anë të zbatimit të sistemit të kredive ECTS, bënë që të realizohet përfshirja e studentëve dhe mësimdhënësve nëpër universitet, në fushat e punimeve kërkimore dhe shkencore, i cili bazohej në pika kredituese, në të cilat realizohej bashkëpunim dhe lidhje mes institucioneve arsimore. Studentëve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve iu mundësohej procedurë e përbashkët, që ishte e njohur për lidhje akademike përbrenda universiteteve të vendit si dhe

atyre jashtë vendit. Nga procesi i Bolonjës u demonstrua se lëvizjet e lira të studentëve dhe profesorëve janë një lloj fuqie në kapitalin njerëzor, për arsye se nga ky sistem u inkuadrua apo u aktivizua një rrjedhë ndërkufitare e kapitalit njerëzor, shërbimeve teknologjike dhe punës. Kjo gatishmëri e lëvizjes së studentëve dhe kuadrit akademik, arriti të ngritë në pozicion më të lartë dimensionin e hapësirës europiane të arsimit të lartë në Maqedoni.

Diploma Supplement, apo vendosja e shtojcës në diplomë, mundësonte lëvizje për punësim të qytetarëve të vendit si dhe atyre europian të arsimit të lartë. Vendosja e shtojcës në diplomë do të tregoj për shkallën, kontekstin, përmbajtjen dhe statusin e studimeve të cilat i ka kryer studenti, dhe po me anë të kësaj mundësohej, njohje akademike dhe profesionale, e destinuar për përdorim nga ana e qytetarit, punëdhënësit dhe institucioneve arsimore.

Ndryshim tjetër që ka ndodhur, në arsimin e lartë në ciklin e tretë të studimeve të doktoraturës, ishte ai për punën kërkimore-shkencore, për profesorët me tituj shkencor, i cili hyri në fuqi në vitin 2015. Ndryshimet përmbledheshin në tre pika kyçe;

- Mentori mund të ketë deri në 12 kandidat master (MA);
- Mentori duhet të ketë botuar 6 punime në revistat shkencore ndërkombëtare, ose ka botuar një artikull shkencor në një revistë shkencore me faktorë ndikimi dhe për ta akredituar nga Bordi i Akreditimit;
- Mentorët për tezat master duhet të kenë të botuar vepra në bazë të të dhënave si EBSCO. (Emerald,Scopus,ose Thomson Reuters). (Jashari H ;2014).

Përderisa aplikimi i sistemit të Bolonjës ishte në fillimet e para, nuk mungoi edhe aspekti negativ gjatë zbatimit të këtij sistemi. Universitetet që aplikuan këtë sistem kishin rënie në numrin e studentëve që regjistroheshin në këto universitete. Sepse numri i kredive gjatë viteve të studimeve deridiplomike duhej të përmbanin 240 kredi, dhe jo vetëm 180 kredi siç janë të parapara sipas sistemit të Bolonjës. Tregu i punës kërkonte student 240 GPA.

Kapitulli II: Rishqyrtimi i Literaturës

2.1. Rishqyrtimi i Literaturës - Pjesa Teorike

Me fjalën ‘Reforma në arsim’ nënkuptojmë ndryshime në arsim.

Po ashtu nga reforma arsimore kuptojmë se përfshijnë çdo ndryshim të planifikuar në mënyrën e funksionimit të një sistemi shkollor ose të shkollës, nga metodologjia e mësimdhënies deri te proceset administrative.

Varësisht nga periudhat e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, arrijmë të kuptojmë se reformat apo ndryshimet në arsim gjithnjë kanë marrë forma të ndryshme. Ndryshimet në arsim edhe sot e kësaj dite janë pjesë më rëndësishme e sistemeve arsimore. Fullan thotë se “Ndryshimi është i kudogjendshëm dhe i pareshtur dhe na imponohet në çdo hap që bëjmë. Në të njejtën kohë, sekret i rritjes dhe zhvillimit është që të dish se si t’u bësh ballë forcave të ndryshimit- duke i kthyer forcat pozitive në dobi tonë. E ardhmja e botës është një e ardhme e të nxënit, e përgatitjes për të përballuar ndryshimin.... mëtej vazhdon duke thënë se vetëm duke u ndërgjegjësuar më shumë dhe duke i hyrë në thellësi tërësisë së ndryshimit në arsim, mund të arrijmë të bëjmë diçka për të (Fullan .M;2001 f .5).

Për ndryshimet në shoqëri dhe ndryshimet në arsim profesor Hasan Jashari thotë se “Arsimimi i bën të mundshme ndryshimet në shoqëri. Pasiqë, rrethanat ku jetojnë shoqëritë bëhen komplekse, atëherë që të mbijetojnë shoqëritë patjetër të bëjnë ndërrime të shpeshta në strukturën e tyre. Vetëdija e edukuar jo vetëm që i përkrah ndërrimet, por edhe që më parë e di si të përballlet me ata dhe për t’iu përshtatur në kushte të reja.(Jashari H, 2005 ; f.16). Është e nevojshme që të ndërtohet dhe kuptohet tabloja e madhe, sepse ndryshimi në arsim, në fund të fundit, është një problem shoqëror dhe politik. (Fullan M, 2001; f.23).

Që shkollimi është i nevojshëm dhe shumë i rëndësishëm këtë e dinë të gjithë. Sepse arsimi e ndihmon gjeneratën e re të formohet dhe të edukohet në mënyrë të drejtë dhe me përgjegjësi.

Procesi që e shoqëron njeriun prej ardhjes në këtë botë e deri në vdekje është arsimimi gjatë gjithë jetës, me qëllim të ndryshimit të vetëvetës së tij në çdo etapë të jetës.(Dede Polakaj; 2017)

Arsimi është, në fakt, një mjet i rëndësishëm ndryshimi. Arsimi që rritë lëvizshmërinë shoqërore u lejon gjithashtu individëve të vazhdojnë me ndryshimet shoqërore përmes trajnimit. Po i njejtë autor parafrazon, mendimtarët si Harrin, Freiren, Illichi dhe Kounti mendojnë se arsimi do të sjellë ndryshime rrënjësore në shoqëri. Nëse mendojmë se zhvillimi shoqëror është një proces ndryshimi, është edukimi që u mundëson njerëzve të kuptojnë zhvillimin social duke u dhënë atyre aftësi që do t'u mundësojnë atyre të zhvillohen. (Ajberk.Sh;2017)

Ndryshimet i ndërrojnë të gjithë gjërat, të gjitha institucionet. Ato madje i ndryshojnë edhe individët. Ndryshimet bëhen pjesë përbërëse e sjelljes në përditshmërinë tonë. Ato reflektohen edhe ndaj jetës familjare. Torsten Veblen në një vepër të tij në lidhje me klasat, bën fjalë për njeriun bashkëkohorë në shoqërinë qytetare si për një pjesë të vogël të një “maqinerie” ekonomike e cila lëviz dhe e vendos njeriun në lëvizje e cila nuk është e thënë që patjetër t’i pëlqejë atij. (Jashar H, 2005; f.104)

Ndryshimi është ligji i jetës dhe ndryshimet në shoqëri gjithmonë po ndodhin. Ndryshimet mund të jenë të ngadalta, aq të ngadalta sa që njerëzit nuk i perceptojnë ato, ka raste kur ato janë kaq të shpejta dhe drastike. Në të gjitha sferat e jetës gjërat po ndryshojnë në sferën ekonomike, në fushat politike, në sferën e arsimit e kështu me radhë. Ndryshimet shoqërore në masë të madhe janë sjellë përmes procesit të edukimit. Arsimi inicion, udhëzon dhe kontrollon lëvizjet për reformën sociale (Amad.S ;2007-2008).

Është e qartë që kjo shoqëri duhet të zhvillohet në bazë të parimeve individualiste duke e nxitur konkurrencën. E tërë ajo duhet të përmbahet me një proces më të gjithanshëm të integritetit dhe

duhet patur kujdes në të bërit e një kohezioni ndërmjet grupeve të ndryshme në bazë të interesit të përbashkët, i cili interes i përbashkët gjithmonë jep rezultate më të mira dhe ndikon më pozitivisht se kur ai është vetanak (Jashari. H ; 2005, f.161).

Njerëzit përfshihen në ndryshim, vullnetarisht ose jo, dhe në secilin rast përjetojnë një lloj paqartësie, përse i përket kuptimit, formës dhe pasojave të tij. Nga ana objektive është e mundur të sqarohet kuptimi i një ndryshimi në arsim, duke përshkruar, veç e veç, përmasat e tij kryesore...Ekziston rreziku, që realiteti objektiv të jetë, thjesht, një version i zbukuruar i koncepteve të tyre subjektive (Fullan M; 2001 f. 65).

Çdo ditë me intensitet më të madh janë duke u imponuar zhvillimi ekonomik, kërkesat e shoqërisë së informacioneve dhe progresi i madh tekniko-teknologjiko-shkencorë. Këto zhvillime dhe hapat të cilët ndërmerren kërkojnë lloje të reja të punës prandaj prej të gjithë shkollave kërkohen njohje të reja dhe shkathtësi progresive e rezultative. Ndryshimet e ndërrojnë rrugën e jetës tonë me atë që ato ndryshime nuk janë të rastësishme, por janë udhëzues të ardhmërisë së shoqërisë. (Edit Kreson, 7.H Jashari.2005.fq.164)

Ka arsye të thella teorike dhe zhvillimore që na bëjnë të besojmë, se shoqëria do të jetë më e fortë, nëse arsimit i shërben qëllimit që t'i ndihmojë njerëzit të punojnë, së bashku, për të arritur qëllime të larta, të cilat i shërbejnë të mirës së individit, ashtu edhe asaj të shoqërisë. (M.Fullan v.1993-1999 fq. 406). Sot në botë ekziston tendencë e fuqishme për krijimin e shoqërisë ndërmarrëse, sikurse në vendet e zhvilluara ashtu edhe në vendet në tranzicion. Baza e secilës shoqëri ndërmarrëse është krijimi i vetëdijes dhe kulturës ndërmarrëse të secili individ dhe shoqërisë në përgjithësi. (PNZHA;2005-2015).

Përpara punonjësve të arsimit dhe programeve të tyre të punës zhvillimore, paraqitet një detyrë e rëndësishme strategjike për rolin dhe profilin e ri të shkollës. Ai duhet të orientohet

në drejtim të kërkesave të reja të njeriut që të mund të aftësohet për të pasur sukses në jetë dhe që të mundet të mbijetojë në shoqërinë e kohës e cila është e bazuar dhe ndërtuar në posedim të dijeve dhe kompetitivitetit të diturive” (Jashari. H; 2005 f.162).

Arsimi është elementi kryesor për jetën sociale dhe ekonomike të shoqërisë. Forca e arsimit cilësor jep rezultate në dy nivele: në nivel të zhvillimit personal të qytetarit dhe në nivel të zhvillimit të shoqërisë. Në nivel personal, arsimi u mundëson njerëzve që të përvetësojnë dije, shkathtësi dhe që të formojnë qasje për mendim kritik dhe bërjen e zgjedhjes lidhur me përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre. Në nivel shoqëror, arsimi paraqet sektor strategjik nga i cili varet zhvillimi i gjithëmbarshtëm i bashkësisë”. (Strategjia për zhvillimin e Arsimit; 2015-2020).

Agjentë të ndryshimit Fullan i quan mësuesin, ku thotë se çdo mësues duhet të përpiqet që të bëhet agjent, pra një agjent efektiv i ndryshimit, ku duhet të filloj me ndërtim të vizionit vetanak, sepse ai lidhet shumë mirë me forcat e ndryshimit. Qëllimi vetjak, në mësuesi duhet të marrë shtysa të vazhdueshme, derisa të vendosi lidhje në përmirësimin shoqëror në shoqëri (Fullan M; 1999-1993 f. 28).

Fullan për qëllimin moral të arsimit thotë se është të sjellë në jetë ndryshim në jetën e nxënësve, pavarësisht nga prejardhja e tyre, shoqërore, dhe të ndihmoj në krijimin e qytetarëve, që mund të jetojnë e punojnë në mënyrë produktive në shoqëri, gjithnjë e më dinamike dhe më të ndërlikuar. Shoqëria , pret nga qytetarët që të jenë të aftë të merren, me ndryshimin në mënyrë proaktive gjatë gjithë jetës, si individualisht ashtu edhe kolektivisht, në kontekstin e një shndërrimi global (Fullan.M; 1993-1999 f.15). Ndryshimi arsimor produktiv, në thelbin e vet, nuk është aftësia për të zbatuar politikën e fundit, por aftësia për të mbijetuar kthesat e papritura të ndryshimit të planifikuar dhe paplanifikuar, ndërkohë që përparon dhe zhvillohesh” (Fullan.M; 1993-1999 f .17).

Fullan ndryshimin e përqëndron tek individi, duke thënë se faktorët e jashtëm ndikojnë tek

individit, pavarësisht nëse ai e dëshiron një gjë të tillë, kështu që aftësia për të menaxhuar ndryshimin është një aftësi thelbësore në shoqërinë post-moderne. Ndryshimi është i detyrueshëm, zhvillimi është me dëshirë (Laing, 1992). Pra ne nuk e kemi në dorë të zgjedhim “ndryshim a jo ndryshim”, por e kemi në dorë se si të reagojmë. Së dyti, përqendrimi tek individit nuk është zëvendësues në shkallë sistemi, por është strategji më efektive për arritjen e tij (Fullan. M; 1993-1999 f.181).

Për përhapjen e ndryshimit në praktikë Fullan, teoria e ndryshimit në arsim është një teori e pyetjeve që nuk marrin përgjigje. Askush nuk e din, me siguri, se çfarë është më e mira. Ne jemi të përfshirë në një teori të provimit, dhe kuptimit të mëdysheve të shumëfishta, në përpjekje për të vendosur se çfarë duhet të bëjë. Fillimi është proces që çon në marrjen e vendimit, për të vazhduar me zbatim, që e përfshin edhe këtë vendim. Ne mund të mendojmë se ndryshimet e veçanta arsimore hyjnë, sepse janë të dëshirueshme, në bazë të disa vlerave arsimore dhe se ato plotësojnë një nevojë, të caktuar, më mirë se praktikatat ekzistuese. Megjithatë kjo nuk është gjithmonë, madje as zakonisht, mënyra se si ndodhin gjërat (f.86-87). Planifikimi i zbatimit nuk ka të bëjë me vendosjen e një rrjedhe logjike të hapave që dalin nga risia ose reforma me të cilën po merremi. (Fullan M; 2001 f.170-171) .

Shteti është një vegël jashtëzakonisht jo i mprehtë, ai e merr një ide të përgjithshme dhe ua bënë të detyrueshme të tjerëve, pa marrë, aspak, parasysh, rrethanat vendore... Pastaj është edhe dëshira e dëshpëruar e politikanëve, për të zgjedhur një zgjidhje magjike, bota e tyre është që kërkojnë zgjidhje të shpejta, për problem të ngutshme. Mickelkthavi dhe Woldridge (1996), sipas Fullan, qeveritë mund të kërkojnë dhënie llogarie, të krijojnë shtysa (trysni dhe mbështetje) dhe të nxisin ndërtimin e kapaciteteve. Në qoftë se duam të arrijmë reformë në shkallë të gjërë, qeveritë kanë një rol thelbësor. Ato kanë potencialin që të jenë një forcë madhore për shndërrim (Fullan. M ; 2001 f.324-325). Ndryshe Fullan thotë se agjentët e ndryshimit, janë njerëz të vetëndërgjegjshëm për natyrën e ndryshimit dhe procesin e ndryshimit. Ata pranojnë idenë e zbulimit të qëllimeve të reja gjatë rrugës (Fullan.M; 1993-

1999 f.25). T'i përkushtohesh zhvillimit të kapitalit shoqëror dhe intelektual, do të thotë të kuptosh synimin e qëllimit moral; ta trajtosh atë në mënyrë produktive, do të thotë të futesh në ndërlikimet e kompleksitetit dhe ndryshimit" (Fullan. M; 2001 f .37) .

Arsimi cilësor dhe kapitali njerëzor paraqesin një kusht thelbësor për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social. Prandaj, në Republikën e Maqedonisë, në të gjitha këto vite që nga pavarësia e saj e deri më sot, reformat në sektorin e arsimit janë vazhdimisht aktuale apo bëhet përpjekje dhe investohet vazhdimisht me qëllim që të përmirësohet cilësia e arsimit si dhe niveli i njohurive dhe aftësive tek nxënësit" (TENS ; 2016).

Nevoja për hyrje strategjike në transformimin e arsimit të lartë nuk përbën vetëm detyrim prej ndryshimeve që ndodhin në nivel nacional, por ai është implikim dhe prej ndikimit të të ashtuquajturve faktorë të jashtëm, domethënë globalë, të gjithanshëm, të cilët e përkufizojnë arsimin e lartë dhe në vendet e tjera të botës (PNZHA ; 2005-2015).

Kapitali privat po depërton dhe pavarësisht në dobësitë dhe kushtet e reja të afertave të shumëfishta , supozimi im është, se do të japin efektet pozitive. Shkollat dhe sidomos arsimi i lartë ndikohet fuqishëm nga faktorët e jashtëm që po ndodhin në ekonominë globale, patjetër do të japin efektet e tyre në shkolla , në përgatitjen e gjeneratave të reja për njohuri, shkencë dhe profesione të reja (Jashari H; 2014) .

Prirja e studentëve nga arsimi i lartë gjithmonë ka qenë përgatitja më e mirë për t'u integruar më lehtë në tregun e punës. Në të njetën kohë punëdhënësit kanë kërkesa dhe kritere për t'i punësuar të diplomuarit nga institucionet e arsimit të lartë. Kjo në mënyrë ideale nënkupton që aftësitë dhe shkathhtësitë e individëve që kërkojnë punë duhet të përputhen me kërkesat e kompanive (Emini. R; 2010 f.113).

Institucionet e larta arsimore duhet të zhvillojnë dhe programe të studimit (apo sete modulesh) të cilat do të jenë në funksion të kualifikimit, rikualifikimit të studentëve të diplomuar dhe të gjithë atyre që kanë nevojë për marrjen e kualifikimit me të cilin do të jenë konkurrentë pune jo vetëm në tregun nacional të punës por edhe në atë evropian. Ndërtimi i këtyre programeve

të studimit duhet t'i ndjekë ndryshimet në tregun e punës si në vendin amë ashtu edhe në Evropë dhe në botë (PNZHA ; 2005-2015).

Në ekonomitë që karakterizohen nga ndryshimet dhe shfaqja e paradigmeve të reja të prodhimit të bazuar në dije dhe në zbatimin e saj dhe në përpunimin e informatës, lidhje mes arsimit të lartë, botës së punës dhe sferave të tjera të shoqërisë duhet të forcohen dhe përtërihen. Kjo bëhet nëpërmjet pjesëmarrësve së përfaqësuesve të arsimit të lartë në qeverisjen e institucioneve, përdorim më të madh të punës praktike kombëtare, dhe ndërkombëtare , mundësi për punë –studim për student dhe mësimdhënës, këmbim të personelit, ndërmjet botës së punës dhe institucioneve të arsimit të lartë, si dhe kurrikulumi i rishikuar i lidhur me praktikën e punës (Emini. R; 2010 f.112).

Shoqëria e re kërkon rrugë të reja të zhvillimit, dije të reja dhe metoda të reja të punës. Numri i tepërt i lëndëve të cilat shpeshherë ishin në funksion të ngritjes ideologjike dhe vizioneve kolektiviste është që patjetër të ndërrohen me lëndë të reja dhe përmbajtje mësimore të cilat do të jenë në përputhje me përfitimet e reja arsimore dhe qytetëruese (Jashari.H; 2005 f.172) .

Në botë tani më është vendosur paradigma: nga shoqëria që mëson, në shoqëri që din. Bëhet fjalë për shoqëri të qytetarëve proaktiv dhe qytetarëve ndërmarrës. Në këtë kontekst, arsimit fiton rol kyç. Njëherësh, në shkollat tona duhet të edukohen individë të cilët do të jenë të aftë që të ballafaqohen me sfidat e kohës në të cilën do të jetojnë dhe punojnë. Procesi interaktiv i të mësuarit që nga fëmijët do të krijojë, ashtu siç prejudioi në mënyrë metaforike filozofi i njohur Edgar Moren, “kokë që mendon e jo kokë që mban mend”, do të duhej të jetë thelbi i reformave të përgjithshme në arsim, jo vetëm te ne por edhe më gjërë (PNZHA ;2005-2015).

Kapitulli III: Metodologjia

3.1. Qëllimi i hulumtimit

Si pjesë më e rëndësishme në këtë punim magjistrature, është paraqitja në mënyrë përshkruese e çdo aspekti të hulumtimit që është përdorur në këtë punim, për t'iu përgjigjur pyetjeve të hulumtimit si dhe për të nxjerrur rezultatet nga hipotezat. Ajo që do të paraqes në këtë kapitull është prezantimi i metodologjisë së përdorur.

Qëllimi i kërkimit, është ai se reformat kanë qenë gjithmonë pjesë e pandashme e proceseve arsimore, dhe gjithmonë kanë sjellur inovacione dhe ndryshime në sistemet arsimore. Mirëpo ajo që ka rëndësi në këtë punim për këto reforma është Reformat- si çelës i zhvillimit të arsimit në Maqedoni, duke i bartur të gjitha dinamikat dhe problemet e tyre të ndryshimit në vetvete.

Pyetjet e këtij hulumtimi janë:

1. Kur dhe pse ishin të nevojshme reformat e arsimit të Maqedonisë? si dhe
2. Cili është çelësi apo metoda për zbatimin më të suksesshëm të tyre në arsim si segment më i ndjeshëm i shoqërisë?

3.2. Metodatat e përdorura në këtë hulumtim

Ndonëse hulumtimi në shkenca shoqërore është diçka e veçantë, ai është proces, dhe nuk ndodhë vetvetiu, ai duhet të ketë gjithmonë një qëllim. (Bob Mathews & Liz Ross ;2010 f.7-9) Për hulumtimin në këtë punim janë mbledhë të dhëna nga veprimtaria praktike, nën kufizime kohore, hapësinore dhe burimore. Me anë të mjeteve të hulumtimit është bërë organizimi dhe menaxhimi i mledhjes së të dhënave.

Në këtë punim mjetet e hulumtimit kanë qenë fletëanketat, pyetjet e së cilës kanë qenë të strukturuar në formatin me të cilin të anketuarit kanë pasur një nga pesë alternativat në përgjigje si: *pajtohem plotësisht, pajtohem, ndonjëherë pajtohem ndonjëherë jo, nuk pajtohem aspak, nuk pajtohem*. Të anketuarit në këtë punim kanë qenë mësuesit në shkollat fillore dhe të mesme në qytetin e Shkupit si dhe një shkollë fillore në Komunën e Likovës. Nëpër shkolla janë dorëzuar fletëanketat dhe në afat kohor prej shtatë ditëve janë marrë të plotësuara nga ana e të anketuarve.

Për të arritur në rezultatet e parapara në këtë punim, i cili ka karakter hulumtues, janë përdorur këto metoda të hulumtimit: ajo e metodës teorike, metodës deskriptive ose përshkruese, metodës komparative (krahasuese) dhe metoda analitike.

Duke u nisur nga historia e zhvillimit të arsimit dhe reformave arsimore, me anë të metodës teorike që janë të nxjerrura nga shkenca e arsimit nga autorë të huaj dhe vendor, në këtë punim kam paraqitur disa raste në lidhje me lëndën e hulumtimit.

Gjithashtu kam përdorur edhe metodë përshkruese, të cilën e kam shfrytëzuar gjatë hulumtimit, që ishin të paraqitura si ligje, rregullore, raporte, doracak etj. Pastaj kam bërë edhe krahasimin e asaj që si janë paraqitur reformat dhe si ka ecur realizimi i tyre në vendin tonë.

3.3. Hipotezat

Hipotezat kryesore të këtij punimi janë dy:

- **Hipoteza gjenerale:**

Reformat – çelësi i zhvillimit të suksesit në Maqedoni dhe nevoja që kishte arsimit për këto reforma.

- **Hipoteza e veçantë:**

Si hipotezë të veçantë kam zgjedhur rezultatet nga reformat në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në Maqedoni.

-Reformat dhe ndryshimet në zbatimin e tyre:

- Koncepti për arsimin fillor nëntëvjeçar;
- Testimi ekstern;
- Sistemi i Bolonjës.

Kapitulli IV: Analizimi i të Dhënave


Në këtë kapitull do të prezentohen, analizohen rezultatet që janë marrë nga instrumentet kërkimore. Rezultatet janë nxjerrë nga fletëanketat që ishin të anketuar mësime të shkollës së mesme si dhe mësime të shkollës fillore.

Në këtë hulumtim kanë qënë të përfshirë 50 mësime të shkollës së mesme prej të cilëve 18 kanë qënë të gjinisë mashkullore, dhe 32 të gjinisë femërore, si dhe 46 mësime të shkollës fillore, prej të cilëve 20 kanë qënë të gjinisë mashkullore, dhe 26 të gjinisë femërore.

4.1. Rezultatet nga anketat në shkollat fillore


Reformat në arsim kanë si qëllim rritjen e cilësisë së arsimit dhe përshtatjen e sistemit tonë arsimor me vendet më të zhvilluara, duke u nisur nga organizimi, përmbajtja dhe udhëheqja e sistemeve arsimore.

4.1.1. Shkolla efektive promovon, praktikon dhe ndihmon që të ketë mirëqenie dhe të drejta për të gjithë fëmijët në bashkësi.




Në grafikonin 4.1.1 nga gjithsejt 46 arsimtar të anketuar, shohim se 17 arsimtar janë përgjigjur me variantin pajtohem plotësisht, 18 me pajtohem, 8 me ndonjëher pajtohem ndonjëherë jo, nuk pajtohem aspak vetëm 1, dhe nuk pajtohem asnjëri. Prej rezultateve të anketave mund të vërehet se 80% e arsimtarëve pajtohen me atë se shkolla efektive, promovon praktikon dhe ndihmon, që të ketë mirëqenie dhe të drejta për të gjithë fëmijët njësoj.

4.1.2. Unë dua që fëmijët e mi të mësojnë me këto libra shkollore dhe këto plane mësimore.




Në grafikonin 4.1.2 nga gjithsejt 46 arsimtar të anketuar, 2 janë përgjigjur me variantin pajtohem plotësisht, 10 me pajtohem, 13 me ndonjëherë pajtohem, ndonjëherë jo, 11 me nuk pajtohem aspak, 10 me nuk pajtohem. Prej rezultateve mund të vërej se 46% nga arsimtarët nuk pajtohen që fëmijët e tyre të mësojnë me këto libra shkollor, 28% prej tyre tregojnë dilemë për këtë pyetje, ndërsa vetëm 26 % prej tyre pajtohen.

4.1.3. Notimi përshkrues për klasat 1 dhe 2 solli vetëbesim, aktivizëm dhe zgjuarsiri tek nxënësit.




Në grafikonin 4.1.3. nga 46 arsimtar të anketuar, 5 prej tyre janë përgjigjur me variantin pajtohem plotësisht, 10 me pajtohem, 15 me ndonjëherë pajtohem, ndonjëherë jo, 10 me nuk pajtohem aspak, dhe 6 me nuk pajtohem. Nga rezultatet vërejmë se 35 % e arsimtarëve nuk pajtohen se notimi përshkrues ka sjellur aktivizëm tek nxënësit, 32 % prej tyre janë të pavendosur dhe 33% prej tyre pajtohen se ky lloj notimi ka sjellur aktivizëm dhe zgjuarsiri tek nxënësit.

4.1.4. Arsimi fillor nëntëvjeçar 3+3+3 ishte një sistem që solli rezultate të dukshme.




Në grafikoni 4.1.4. nga 46 arsimtarë të anketuar, vetëm 1 është përgjigjur me pajtohem plotësisht, 7 me pajtohem, 21 me ndonjëherë pajtohem ndonjëherë jo, 7 me nuk pajtohem aspak, dhe 10 me nuk pajtohem. Nga rezultatet mund të vërejmë, se 46% prej arsimtarëve janë të pa vendosur, 37% prej tyre nuk pajtohen, 17% prej tyre pajtohen.

4.1.5. Fillimi i viteve të para të aplikimit të sistemit arsimor nëntëvjeçar, filloi me plane dhe programe të përshtatshme në kurrikulë




Në grafikonin 4.1.5. nga gjithsej 46 arsimtarë të anketuar, shohim se asnjëri prej tyre nuk është përgjigjur me pajtohem plotësisht, 14 prej tyre me pajtohem, 18 me ndonjëherë pajtohem ndonjëherë jo, 8 prej tyre me nuk pajtohem aspak, dhe 6 me nuk pajtohem. Nga rezultatet vërejmë se 39 % të arsimtarëve janë të pavendosur, dhe 31% prej tyre pajtohen me 30% që nuk pajtohen.

4.1.6. Tekstet shkollore ishin në përputhje të plotë me objektivat e pritura sipas kurrikulës




Nga grafikoni 4.1.6 nga gjithsejt 46 arsimtarë të anketuar, asnjë nuk është përgjigjur me pajtohem plotësisht, 8 me pajtohem, 20 ndonjëherë pajtohem ndonjëherë jo, 14 me nuk pajtohem aspak, dhe 4 me nuk pajtohem. Nga rezultatet mund të vërejmë se 40 % të pavendosur dhe 39% që nuk pajtohen, tekstet shkollore nuk kanë qenë në përputhje të plotë me objektivat e pritura, dhe 17 % pajtohen.

4.1.7. Mësimdhënësit i mirëpritën këto reforma dhe i ndihmuan që edhe ata të ngriten profesionalisht.




Në grafikonin 4.7. nga 46 arsimtar të anketuar vetëm 1 prej tyre përgjigjet me pajtohem plotësisht, 9 me pajtohem, 24 me ndonjëherë pajtohem ndonjëherë jo, 6 me nuk pajtohem aspak, 6 me nuk pajtohem. Nga rezultatet vërejmë se 52 % janë të pavendosur në lidhje me përgjigjet, 26% prej tyre nuk pajtohen se mësimdhënësit i mirëpritën këto reforma dhe 22% pajtohen.

4.1.8. Rëndësi të madhe ka bashkëpunimi mësimdhënës, nxënës dhe prindër




Në grafikoni 4.1.8. prej 46 arsimtarve të anketuar, 31 prej tyre janë përgjigjur me pajtohem plotësisht, 10 prej tyre me pajtohem, 2 prej tyre me ndonjëherë pajtohem ndonjëherë jo, 2 me nuk pajtohem aspak, dhe 1 me nuk pajtohem. Nga rezultatet e anketave vërehet se 90% e arsimtarëve të anketuar pajtohen se rëndësi ka bashkëpunimi në mes trekëndëshit mësimdhënës, nxënës dhe prind dhe 6% prej tyre nuk pajtohen.

4.1.9. Refomat në sistemin arsimor në Maqedoni e bënë përgatitjen e duhur të nxënësve, për t'iu përshtatur sa më lehtë ndryshimeve në shoqëri



Në grafikoni 4.1.9, prej 46 arsimtarëve të anketuar, prej asnjërit prej tyre nuk kemi përgjigje se pajtohet plotësisht, 14 prej tyre pajtohen, 18 prej tyre ndonjëherë pajtohem ndonjëherë jo, 12 prej tyre nuk pajtohem aspak, 2 prej tyre nuk pajtohen. Nga rezultatet vërejmë se 39 % janë të pavendosur, dallim të vogël kemi tek ata që pajtohen dhe nuk pajtohen në mes 31%-30%.


4.1.10. Në të ardhmen dua që arsimtarët të jenë kryesorët në përcaktimin e njësive mësimore të cilat përdoren në mësimdhënie dhe punohet në shkolla.



Në grafikonin 4.1.10. prej 46 arsimtarëve të anketuar, 31 prej tyre janë përgjigjur me pajtohem plotësisht, 9 prej tyre me pajtohem, 4 prej tyre ndonjëherë pajtohem ndonjëherë jo, 1 me nuk pajtohem aspak dhe 1 me nuk pajtohem. Nga rezultatet vërejmë se 87% prej tyre pajtohen që në të ardhmen arsimtarët të jenë kryesorët në përcaktimin e njësive mësimore të cilat përdoren në mësimdhënie dhe punohet në shkolla dhe 4% nuk pajtohen.

4.2. Rezultatet nga Anketat në Shkollën e Mesme


4.2.1. Shkolla efektive promovon, praktikon dhe ndihmon që të ketë mirëqenie dhe të drejta për të gjithë fëmijët në bashkësi



Nga grafikoni 4.2.1. ku kanë qenë të anketuar 50 mësimdhënës në shkollë të mesme, 29 prej tyre deklaruan se pajtohen plotësisht, ndërsa 21 prej tyre pajtohen, asnjëri prej tyre nuk është përgjigjur me ndonjëherë pajtohem ndonjëherë jo, nuk pajtohem ose nuk pajtohem aspak.


Nga rezultatet mund të vërejmë se 58 % e mësimdhënësit kanë të qartë se çfarë promovon dhe praktikon shkolla efektive.

4.2.2. Unë dua që fëmijët e mi të mësojnë me këto libra shkollor dhe këto plane mësimore



Nga grafikoni numër 4.2.2. prej 50 mësimdhënësve që janë përgjigjur në fletëanketa, pamë se 5 prej tyre pajtohen, 39 prej tyre ndonjëherë pajtohen ndonjëherë jo, ndërsa 6 prej tyre nuk pajtohen aspak. Sipas rezultatetve vërejmë se 10% e mësimdhënësve pajtohen që me këto libra duan që të mësojnë fëmijët e tyre, ndërsa 12% nuk pajtohen.


4.2.3. Ka raste që janë keqpërdorur disa aspekte reformuese në arsimin e mesëm, si psh. liria e 'tepruar' e nxënësve



Nga grafikoni 4.2.3. prej 50 mësimdhënësve që janë përgjigjur, shohim se 10 prej tyre


pajtohen, 23 ndonjëherë pajtohen, ndonjëherë jo, dhe 17 prej tyre nuk pajtohen aspak, nuk kemi mësimdhënës në këtë pyetje që pajtohet plotësisht si dhe nuk pajtohet. Sipas rezultatetve vërejmë pavendosmërinë e mësimdhënësve e cila ka përqindje më të madhe 46%, dhe 34% prej tyre që nuk pajtohen, 20% pajtohem.

4.2.4. Arsimi fillor nëntëvjeçar, tregoi rezultate tek nxënësit në shkollat e mesme.




Nga grafikoni 4.2.4. prej 50 mësimdhënësve të anketuar, ajo çka shohim është se 40 prej tyre pajtohen plotësisht, dhe 10 prej tyre pajtohen, ndërsa nuk kemi asnjë mësimdhënës me përgjigje ndonjëherë pajtohem ndonjëherë jo, nuk pajtohem aspak dhe nuk pajtohem. Nga kjo shohim se arsimi fillor nëntëvjeçar ka treguar rezultate të dukshme në shkollat e mesme. Sipas rezultateve vërejmë se kemi pajtueshmëri të plotë të mësimdhënësve në shkollat e mesme që ka ndikuar aplikimi i sistemit fillor nëntëvjeçar tek nxënësit në shkollat e mesme.

4.2.5. Fillimi i viteve të para të aplikimit të sistemit të ri arsimor, kishin filluar me plane dhe programe të përshtatshme në kurrikulë.




Në grafikoni 4.2.5. prej 50 mësime dhënë të anketuar, 41 prej tyre përgjigjen me ndonjëherë pajtohem ndonjëherë jo dhe 9 prej tyre nuk pajtohen aspak, ndërsa mësime dhënë me përgjigje pajtohem plotësisht, pajtohem si dhe nuk pajtohem nuk kishte. Nga kjo mund të vërejmë dilemën e mësime dhënë rreth asaj si ka filluar aplikimi i sistemit të ri arsimor, ku 18% nuk pajtohen.

4.2.6. Tekstet shkollore ishin në përputhje të plotë me objektivat e pritura sipas kurrikulës.




Nga grafikoni 4.2.6. prej 50 mësimdhënësve të anketuar, 36 prej tyre janë përgjigjur me ndonjëherë pajtohem ndonjëherë jo, 12 prej tyre nuk pajtohem aspak, si dhe 2 prej tyre me nuk pajtohem, asnjë mësimdhënës nuk është përgjigjur me pajtohem plotësisht ose pajtohem. Nga rezultatet vërejmë se 28% nuk pajtohen se tekstet shkollore kanë qenë në përputhje të plotë me objektivat e pritura sipas kurrikulës.

4.2.7. Aplikimi i reformave dhe standardet që sollën ato i gjetën shkollat të përgatitura me infrastrukturë të disponueshme.




Nga grafikoni 4.2.7. prej 50 mësimdhënësve të anketuar, 7 prej tyre përgjigjen me pajtohem, 22 prej tyre ndonjëherë pajtohem ndonjëherë jo, 20 prej tyre me nuk pajtohem aspak, dhe 1 prej tyre me nuk pajtohem, ndërsa me pajtohem plotësisht asnjë mësimdhënës. Nga rezultatet vërejmë se 42% nuk pajtohen se shkollat kanë qenë të përgatitura me kushte për aplikimin e reformave.

4.2.8. Aplikimi i arsimit të mesëm të obliguar ndikoi pozitivisht në mirëqenien e jetës së qytetarëve.




Në grafikoni 4.2.8. prej 50 mësimdhënësve të anketuar, 30 prej tyre përgjigjen me pajtohen plotësisht, 17 prej tyre me pajtohen, 3 prej tyre me ndonjëherë pajtohem ndonjëherë jo, ndërsa me nuk pajtohem aspak dhe nuk pajtohem, nuk kemi të përgjigjur. Nga rezultatet mund të vërejmë se 94% e mësimdhënësve, pajtohen se fillimi i aplikimit të arsimit të mesëm të obliguar ka ndikuar pozitivisht tek qytetarët.

4.2.9. Reformat në sistemin arsimor në Maqedoni e bënë përgatitjen e duhur të nxënësve, për t'iu përshtatur sa më lehtë ndryshimeve në shoqëri.



Në grafikonin 4.2.9 prej 50 mësimdhënësve të anketuar, 2 prej tyre përgjigjen me pajtohem, 38 prej tyre me ndonjëherë pajtohem ndonjëherë jo, 10 prej tyre me nuk pajtohem aspak, përgjigje me pajtohem plotësisht dhe nuk pajtohem, nuk kemi. Nga rezultatet vërejmë se 20% e mësimdhënësve nuk pajtohen dhe vetëm 4% pajtohen se reformat në Maqedoni bënë përgatitjen e duhur të nxënësve për t'iu përshtatur sa më lehtë ndryshimeve në shoqëri.

4.2.10. Në të ardhmen dua që mësimdhënësit të jenë kryesorët në përcaktimin e planeve dhe njësive mësimore të cilat përdoren në mësimdhënie dhe punohet në shkolla



Në grafikonin 4.2.10 prej 50 mësimdhënësve të anketuar shohim se të gjithë janë përgjigjur me pajtohem plotësisht. Si përfundim vërejmë se mësimdhënësit duan të jenë kryesorët në përcaktimin e planeve dhe njësive mësimore të cilat përdoren në mësimdhënie dhe punohet nëpër shkolla.

Kapitulli V: Përfundimi

Në këtë punim magjistrature është bërë përpjekje për të treguar nevojën, ecjen dhe përfundimet nga reformat në sistemin arsimor në Republikën e Maqedoni. Përfundimi i këtij studimi është nxjerrë nga rezultatet e fletëanketave, raporteve dhe studiuesve akademik. Ky kapitull është i ndarë në katër pjesë, pjesët e së cilës iu përgjigjemi pyetjeve të hulumtimit.

Kjo tezë magjistrature ka mbartur 4 pyetje. Duke u nisur nga rezultatet e marra nga analizat e fletëanketave, dhe duke rishqyrtuar nga literatura, pyetjeve të hulumtimit u përgjigjemi si më poshtë.

1. Cilat ishin reformat apo ndryshimet që ndodhën në arsimin në Maqedoni?

Sikurse në botë ashtu edhe te ne, në dekadën e fundit të shekullit të kaluar dhe në fillim të këtij shekulli, në sistemin arsimor ndeshen inovacione të shumta që nxiten nga ndryshimet e mjedisit që i rrethon. (PNZHA). Sot, ndoshta më shpejt se asnjëherë, është e nevojshme të futen inovacione në arsim. Që të jemi në hap me zhvillimin e mendimit shkencor, ne si MASH vazhdimisht punojmë në modernizimin e arsimit edhe atë në të gjitha fushat, në arsimin fillor, të mesëm dhe arsimin e lartë. Reformat e futura në sistemin arsimor në vendin tonë u përgjigjen nevojave të tregut të punës, sepse sikurse çdo vend edhe ne kemi nevojë për arsim dhe kuadër profesional. (MASH;2016)

Ndryshimet që ndodhën në sistemet arsimore në Maqedoni ishin nisur nga sistemi për arsim fillor, ishte se në arsimin fillor filloi aplikimi i arsimit fillor nëntëvjeçar, duke u nisur nga rritja e kohëzgjatjes së arsimit fillor të detyrueshëm, si dhe promovimin e arsimit fillor efektiv.

Ndryshim në arsimin e mesëm në Maqedoni ishte ajo që arsimit i mesëm filloi të jetë i detyrueshëm, promovimi i arsimit efektiv si dhe testimi ekstern i nxënësve.

Ndryshime në arsimin e lartë në Maqedoni ishte fillimi i aplikimit të Sistemit të Bolonjës nëpër universitete.

2. Deri në çfarë niveli u implementuan reformat ?

Lidhur me nivelin e implementimit të reformave në sistemet arsimore në Maqedoni, jo në çdo aspekt ka pasur arritje në rezultatet e parashikuara. Arsye për ngecje gjatë implementimit konstatohet të këtë qenë futja e inovacioneve apo risive pa u pilotuar apo vlerësuar aspektet efektive të tyre. (SGJA ; 2017-2020). Palët e ndryshme të interesit nuk kanë qenë plotësisht të informuar dhe të përfshirë në procesin e reformës, aktivitetet dhe iniciativat kanë qenë kryesisht të paqëndrueshme.

Në arsimin fillor edhe pse në disa aspekte ka pasur përparime në progres, aty mund të vërehen edhe ngecje në implementim. Sipas Strategjisë Gjithpërfshirëse të Arsimit aspektet që nuk kanë arritur të kenë implementim të plotë në reforma janë: Fëmijët me nevoja të veçanta arsimore nuk janë të përfshirë sa duhet në arsim, çështja e tyre nuk ka qenë e rregullar me mekanizmat e përshtatshëm. Po ashtu edhe mësimitdhënësit nuk janë me kompetenca të mjaftueshëm për të punuar me këto kategori të nxënësve.

Në lidhje me promovimin e shkollës efektive, dhe puna nëpër shkolla të bëhet, me metoda dhe teknika moderne, mësimitdhënia të bëhet në mënyra sa më bashkëkohore, që mësimi të jetë sa më interaktiv gjatë orëve mësimore. Edhe në këto aspekte ka pasur sfida sipas Strategjisë Gjithpërfshirëse të Arsimit, ku si pasojë e mungesës së mjeteve didaktike dhe kabineteve nuk kanë qenë plotësisht të pajisura me mjetet mësimore. Shumica e shkollave janë të pajisura dobët me pajisje për klasat e larta, por me pajisje shtesë TIK (psh. LCD-projektuesit, tabelat moderne ndryshe nga ato tradicionalet, etj). Metodatat dhe teknikat moderne të mësimitdhënies nuk zbatohen mjaftueshëm në praktikë. Nuk ka ende një platformë

mësimore elektronike për mësim. (SGJA; 2017-2020).

-Metodat tradicionale, ose të themi klasike që mësimdhënësit përdorin me nxënësit akoma i hasim në shkollat tona;

- mjetet e konkretizimit të punës që mësimdhënësit kanë janë jo të favorshme dhe jo efektive për kohën që jetojmë;

-ka mungesë të materialeve dhe teksteve që janë ekskluzive për mësimdhënësit;

-numri i madh i nxënësve nëpër paralele pamundëson punën efektive të procesit mësimor;

Të gjitha këto pika ndikojnë në dobësimin dhe menaxhimin e ngadalshëm të këtyre reformave.

Në Deklaratën botërore për arsimim për të gjithë (Jomtien, 1990) thuhet: “arsimi fillor solid është themel për forcimin e niveleve më të larta të arsimit, shkrim-lexim shkencor dhe aftësi shkencore dhe teknologjike, e me këtë edhe për zhvillim të pavarur... Koha, energjia, si edhe fonde të dedikuara për arsimin fillor janë ndoshta, investimi më largpamës në njerëz dhe në ardhmërinë e një vendi që mund të bëhet... Sot, më shumë se çdoherë, arsimi duhet të kuptohet si dimension bazik në çfarëdo plani social, kulturor ose ekonomik”.(MASH).

Në sistemin e arsimit të mesëm, sidomos atë të arsimit të mesëm të përgjithshëm, nga reformat apo ndryshimet që ndodhën në këtë sistem, nga analiza se deri në cilin nivel janë implementuar, mund të kuptojmë se edhe aty ka pasur ngecje. Sipas raporteve në Strategjinë Gjithpërfshirëse për Arsim, nga analiza e situatës ka çuar në identifikim të këtyre sfidave; kurrikulat janë të mbingarkuara dhe ende mësohet me programe të vjetëruara të cilat nuk kanë dhënë vazhdimësi të zhvillimit social – emocional të nxënësve, nuk janë të mbështetura qasjet moderne për mbajtjen e mësimin dhe nuk pasqyrojnë proceset aktuale shoqërore.

Vlerësimi i cilësisë së kurrikulës dhe programit mësimor dhe vlerësimin të nxënësve nuk

janë konsistente në kuptim të të gjitha faktorëve relevant. (SGJA 2017-2020). Ajo që kuptohet nga analiza e Strategjia Gjithpërfshirëse e Arsimit është se reformat në arsimin e mesëm nuk kanë qenë gjithmonë koherente, dhe nuk ka pasur informacione të vazhdueshme të vlefshme për sistemin arsimor kombëtar në perspektiva ndërkombëtare.

Sistemi për Arsim të lartë sikurse edhe sistemi për arsim të mesëm dhe fillor, verehet se ka nevojë për përmirësime, me qëllim të implementimit të plotë të reformave. Sferat ku ka mungesë të implementimit të reformave në arsim të lartë janë: Programet e studimit dhe lëndëve nuk korrespondojnë me nevojat e tregut të punës, financimi i hulumtimit mbetet e pakënaqshme që në mënyrë të konsiderueshme kontribuon infrastrukturës joadekuate të qendrave të kërkimit shkencor në universitete; fushat tematike prioritare të hulumtimit nuk janë reformuar; qasja në të dhënat shkencore globale është e kufizuar; nuk ka asnjë mekanizëm operativ për komercializimin e zgjidhjeve inovative. (SGJA 2017-2020).

3. Çfarë ndryshime sollën reformat në shoqëri?

Ajo që mund të kuptojmë nga ndryshimet që sollën reformat në shoqëri, si në shumë sektore, poashtu edhe në sistemet arsimore, është domosdoshmëria që ai të ndryshonte nga sistemet e mëparshme, dhe me anë të këtyre ndryshimeve, të hynte në sistem bashkëkohor për arsim sa më të përparuar europian.

Nëse bazohemi në doktrinën se detyra kryesore e arsimit është që të përgatit gjeneratën e re për punë, motivimin e nxënësve që të kalojnë fazat, standardet e shkollimit të përpiluara nga shteti, që të arrihet ai kualifikim, atëherë mund të themi se detyrë parësore në periudhën e transformimeve luan kurrikula dhe përshtatja e tij nevojave të ardhshme për plotësimin e kërkesave të njeriut, pra profesionet e reja. (Jashari .H; 2005. f.23). Duke u nisur nga këto detyra të arsimit, reformat në sistemet arsimore në Maqedoni sipas të dhënave të Entit

Shtetëror për Statistika (ESHS), numri i personave të paditur të rritur, në vitin 2016, krahasuar me vitin 2015, është ulur për 23% (telegrafi.com, 2017). Po ashtu edhe shkalla e papunësisë ka pasur rënie, nga 32.3% në 23.4% në vitin 2016. Papunësia e të rinjve është zvogëluar me rritje të nivelit të arsimit. (SGJA 2017-2020).

4. Cilat ishin rezultatet dhe sukseset e reformave?

Duke u bazuar në rezultatet nga fletëanketat e mësipërme që i realizuam me mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme arrijmë në këto përfundime:

- Mësimdhënësit treguan rezervat e tyre në lidhje me reformat arsimore;
- Mësimdhënësit ishin të pavendosur në përgjigjet që ata dhanë;
- Rezultatet nuk treguan një vijë ndarëse mes atyre që pajtohen me këto reforma ose jo, por treguan një zonë gri që dëshmonte njëfarë hutimi në mesin e tyre;
- Reformat nuk gjetën infrastrukturën e disponueshme për zbatueshmëri, gjë që pati një ngecje dhe nuk pati sukses;
- Aty ku ishin të sigurtë ishin që t'iu rikthehet dinjiteti i mësimdhënësit paralel këtyre reformave, vetëm në këtë mënyrë mund të funksionojnë dhe prosperojnë reformat në arsim në një shoqëri;
- Gjithashtu në bisedat që realizova me disa nga mësimdhënësit në një shkollë fillore, vërejtja se me shqetësim dhe dyshim shikonin këto reforma dhe madje disa hapur me thanë se reformat arsimore duhet të ecin krahas me paga dinjitoze për zbatuesit e këtyre reformave, që mos të përfundojnë këto reforma si një dështim i sigurtë. Pra duhet motivuar, shpërblyer e vlerësuar mësimdhënësit.

- Mësimdhënësit gjithashtu dhanë edhe vlerësimin se suksesi i reformave ishte se ngritën nivelin arsimor në shoqëri si dhe ndikoi pozitivisht në mirëqenien e qytetarëve duke aluduar në kohëzgjatjen e arsimit të mesëm të detyrueshëm.

Bibliografia

Arsimi dhe decentralizimi -2006

<https://www.osce.org/sq/skopje/19361?download=true>

Avzi Mustafa Edukata edhe Arsimi nëpër shekuj 1997

Bashkim Azemi & Remzi Bujari Bazat e kërkimit në edukim 2013

<https://ipkmasht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/11/Bazat-e-kerkimit-n%C3%AB-edukim.pdf>

Bob Mathews & Liz Ross Metodatat e Huluntimit 2010

Dedë Polakaj –Mësimi dhe edukimi process i përhershëm -2017

<http://www.botasot.info/opinione/714727/mesimi-dhe-edukimi-proces-i-perhershem/>

Dr. Edmond Beqiri, ECTS – Sistemi Evropian për Transfer të Kredive, Pejë, 2002

<http://www.uni-gjk.org/upload/dokumentet/92994-ECTS.pdf>

Education and Social Change

<http://www.sociologyguide.com/education/education-and-social-change.php>

Education Reform 1990 –R.Milligand -1990

http://www.austlii.edu.au/au/legis/nsw/num_act/era1990n8200.pdf

Educational Reforms-Religion, Romanticism, and Cultural Reform: 1820–1860

<https://courses.lumenlearning.com/boundless-ushistory/chapter/educational-reforms/>

Eva Drita- Procesi i Bolonjës, koha për ndërtimin e një kulture innovative-2016

<http://uet.edu.al/index.php/sq/evente/1182-procesi-i-bolonjes-koha-per-ndertimin-e-nje-kulture-innovative>

Hasan Jashari Sociologjia e Arsimit 2005

Hasan Jashari –Sociology of reforms and perspectives in higher education 2014

<https://www.thefreelibrary.com/Sociology+of+reforms+and+perspectives+in+higher+education.-a0374810744>

Klemen Miklavic -Arsimi i Lartë dhe Bota e punës; Lidhje të reja nëpërmjet Proçesit të Bolonjes-2009

https://aab-edu.net/assets/uploads/2016/11/02-2009-08_-_Klemen_Miklavic.pdf

Koncepti per arsimin fillor nëntëvjeçar -MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Kronologji, si ka ecur Maqedonia që nga pavarësia e deri me sot -2017

<http://lajmpress.com/kronologji-si-ka-ecur-maqedonia-qe-nga-pavaresia-deri-me-sot/>

Ligji për arsim fillor

http://www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/Zakoni_albanski/Ligj%20p%C3%ABr%20arsimin%20fillor.pdf

Ligji për arsim të lartë

http://www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/Zakoni_albanski/Ligj%20p%C3%ABr%20arsim%20t%C3%AB%20lart%C3%AB.pdf

Majkell Fullan Forcat e ndryshimit Depërtimi në thellësinë e reformës arsimore 1993-1999

Majkell Fullan Kuptimi i r i ndryshimit ne Arsim 2001

Mark K. Smith What is education? A definition and discussion 2015

<http://infed.org/mobi/what-is-education-a-definition-and-discussion/>

Mikel Ndreca Fjalor- Fjalësh e shprehjesh të huaja 2000

Mirela Karabina 2017 Reforma në Arsimin e larte apo Arsimi i Lartë nën Reforma

<http://www.panorama.com.al/reforma-ne-arsimin-e-larte-apo-arsimi-i-larte-nen-reforme/>

Programi Nacional për Zhvillim e Arsimit në Republikën e Maqedonis 2005-2015

https://www.academia.edu/7973919/PROGRAMI_NACIONAL_P%C3%8BR_ZHVILLIMI_N_E_ARSIMIT_N%C3%8B_REPUBLIK%C3%8BN_E_MAQEDONIS%C3%8B_2005_-_2015_ME_DOKUMENTET

PSE REFORMA DHE PROGRAME TË REJA MËSIMORE?

https://roo.mk/sq/pse-reforma/#_ftnref1

Plan Program i Shkollës 2016-2017

Rashit Emini Menaxhimi Financiar ne Univerzitetin e Evropes Juglindore 2010

Reformat në arsim u përgjigjen nevojave të tregut të punës 2016

<http://www.botasot.info/maqedonia/529778/ademi-ne-turqi-reformat-ne-arsim-u-pergjigjen-nevojave-te-tregut-te-punes/>

Sajjad Amad Education and social changes 2018

<https://sol.du.ac.in/mod/book/view.php?id=1449&chapterid=1332>

Shahin Ajberk –Arsimi nuk e ndryshon botën, arsimi i ndryshon njerëzit dhe njerëzit ndryshojnë botën -2017

<http://www.egitimajansi.com/sahin-aybek/egitim-dunyayi-degistirmez-egitim-insanlari-degistirir-insanlar-da-dunyayi-degistirir-kose-yazisi-1087y.html>

Si deri te e Drejta Administrative – Zbatimi i Ligjit të procedurës së përgjithshme administrative në sferën e arsimit – Shkup 2008

<http://www.pravda.gov.mk/dui/pdf/Brosura%20kancelarisko%20rabotenje%20alb.pdf>

Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijet nën moshën 0-6 vjeçare- 2009

https://www.unicef.org/tfymacedonia/MK_Pub_ELDS_ALB.pdf

Strategjia për zhvillimin e Arsimit 2015-2020 Strugë

<http://www.struga.gov.mk/wp-content/uploads/2018/04/Strategjia-p%C3%ABr-zhvillimin-e-arsimit.pdf>

Strategjia Gjithëpërfshirëse e Arsimit 2017-2020 dhe Plani Akcional

Teoria e Mesimit –Faton Beqaj 2018

<http://www.botasot.info/opinione/714727/mesimi-dhe-edukimi-proces-i-perhershem/>

Testimi extern, notimi, sfidat dhe hapat e ardhshëm ; Testimi extern me çdo kusht? 2016

<http://zipinstitute.mk/wp-content/uploads/2012/09/eksterno-al-final.pdf>

There is Another Way: A Different Approach to Education Reform John Berry & 2003

<http://journals.sagepub.com/doi/pdf/10.1177/003172170308400905>

USAID Projekti për arsim fillor- PEP Komponentat për renovimin e shollave

http://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/toolbox/ALB/MODULI_4_prezentimi.pdf D

Western Europe - Educational Roots, Reform in the Twentieth Century, Contemporary
Reform Trends, Future Challenges

Shtojcat

Fletëanketim	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Ndonjëherë pajtohem, ndonjëherë jo	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Gjithsejt
Reformat në arsim kanë si qëllim rritjen e cilësisë së arsimit dhe përshtatjen e sistemit tonë arsimor me vendet më të zhvilluara, duke u nisur nga organizimi, përmbajtja dhe udhëheqja e sistemeve arsimore.						
1. Shkolla efektive promovon, praktikon dhe ndihmon që të ketë mirëqenie dhe të drejta për të gjithë fëmijët në bashkësi.	1	2	3	4	5	
2. Unë dua që fëmijët e mi të mësojnë me këto libra shkollore dhe këta plane mësimore	1	2	3	4	5	
3. Notimi përshkrues për klasët 1 dhe 2 solli vetëbesim, aktivizëm dhe zgjuarsiri tek nxënësit.	1	2	3	4	5	
4. Arsimi fillor nëntëvjeçar 3+3+3, ishte një sistem që solli rezultate të dukshme.	1	2	3	4	5	
5. Fillimi i viteve të para të aplikimit të sistemit arsimor nëntë vjeçar, filloi me plane dhe programe të përshtatshme në kurrikulë.	1	2	3	4	5	
6. Tekstet shkollore ishin në përputhje të plotë me objektivat e pritura sipas kurrikulës.	1	2	3	4	5	
7. Mësimdhënësit i mirëpritën këto reforma	1	2	3	4	5	

dhe i ndihmuan që edhe ata të ngriten profesionalisht.						
8. Rëndësi të madhe ka bashkëpunimi mësimdhënës, nxënës dhe prindër.	1	2	3	4	5	
9.Reformat në sistemin arsimor në Maqedoni e bënë përgatitjen e duhur të nxënësve, për t'iu përshtatur sa më lehtë ndryshimeve në shoqëri.	1	2	3	4	5	
10.Në të ardhmen dua që arsimtaret të jenë kryesorët në përcaktimin e planeve dhe njësive mësimore të cilat përdoren në mësimdhënie dhe punohet në shkolla	1	2	3	4	5	

1. Meshku 2. Femra (rretho)

Ju lutemi që të rethoni një numer në çdo grafë horizontale, lartë e keni shkallën e pajtueshmërisë.

Punim Diplome - **Reformat- çelës i zhvillimit të arsimit në Maqedoni**

Kandidati: Liridona Avdili

Mentori: Hasan Jashari

Data e mbushjes te pyetesorit_____

Pyetsori mund te jetë edhe anonim, vetëm me nënshkrim

Fletëanketim Reformat në arsim kanë si qëllim rritjen e cilësisë së arsimit dhe përshtatjen e sistemit tonë arsimor me vendet më të zhvilluara, duke u nisur nga organizimi, përmbajtja dhe udhëheqja e sistemeve arsimore.	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Ndonjëherë pajtohem, ndonjëherë jo	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Gjithsejt
1. Shkolla efektive promovon, praktikon dhe ndihmon që të ketë mirëqenie dhe të drejta për të gjithë fëmijët në bashkësi.	1	2	3	4	5	
2. Unë dua që fëmijët e mi të mësojnë me këto libra shkollore dhe këta plane mësimore	1	2	3	4	5	
3. Ka raste që janë keqpërdorur disa aspekte reformuese në arsimin e mesëm, si psh. liria e 'tepruar' e nxënësve.	1	2	3	4	5	
4. Arsimi fillor nëntëvjeçar, tregoi rezultate tek nxënësit në shkollat e mesme.	1	2	3	4	5	
5. Fillimi i viteve të para të aplikimit të sistemit të ri arsimor, kishin filluar me plane dhe programe të përshtatshme në kurrikulë.	1	2	3	4	5	
6. Tekstet shkollore ishin në përputhje të plotë me objektivat e pritura sipas kurrikulës.	1	2	3	4	5	
7. Aplikimi i reformave dhe standardet që	1	2	3	4	5	

sollën ato i gjetën shkollat të përgatitura me infrastrukturë të disponueshme.						
8. Aplikimi i arsimit të mesëm të obliguar ndikoi pozitivisht në mirëqenien e jetës së qytetarëve.	1	2	3	4	5	
9. Reformat në sistemin arsimor në Maqedoni e bënë përgatitjen e duhur të nxënësve, për t'iu përshtatur sa më lehtë ndryshimeve në shoqëri.	1	2	3	4	5	
10. Në të ardhme dua që mësimdhënësit të jenë kryesorët në përcaktimin e planeve dhe njësive mësimore të cilat përdoren në mësimdhënie dhe punohet në shkolla	1	2	3	4	5	

1. Meshku 2. Femra (rretho)

Ju lutemi që të rethoni një numër në çdo grafë horizontale, lartë e keni shkallën e pajtueshmërisë.

Punim Diplome - **Reformat- çelës i zhvillimit të arsimit në Maqedoni**

Kandidati: Liridona Avdili

Mentori: Hasan Jashari

Data e mbushjes te pyetesorit _____

Pyetsori mund te jetë edhe anonim, vetëm me nënshkrim